



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org



RAPORTI I PUNËS I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2023

Janar - Dhjetor 2023

Klinë, 2024



PËRMBAJTJA

1. Fjalimi i kryetarit të komunës.....	2
2. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	4
3. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.....	17
4. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.....	20
5. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.....	25
6. Drejtoria për Punë Inspektuese.....	29
7. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.....	34
8. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	43
9. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	55
10. Drejtoria E Financave, Ekonomisë Dhe Zhvillimit.....	60
11. Drejtoria e Arsimit.....	63

Fjalimi i kryetarit të komunës



Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Statutin e Komunës së Klinës, Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2023, kam kënaqësinë që t'ju paraqes Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës së Klinës për periudhën janar-dhjetor 2023, i cili përfshinë punën njëvjeçare, të arriturat e komunës dhe vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar gjatë vitit 2023.

Me gjithë sfidat që kemi pasur, për ekzekutivin vitit 2023 është një vit i realizimit të synimeve dhe objektivave të planifikuara sipas Planit të Punës dhe ligjeve aplikative në fuqi, në përputhje me strategjinë zhvillimore dhe aktet e tjera valide për zhvillimin dhe funksionimin më të mirë për komunën tonë.

Në vazhdimësi jemi angazhuar në arritjen e objektivave dhe qëllimeve tona si qeverisje komunale. Kemi marrë veprime konkrete për përmirësimin e nivelit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit me qytetarë.


Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit me qytetarë, gjatë vitit 2023 kemi mbajtur 2 Takime me Publikun sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku është diskutuar për aktivitetet e gjashtëmujorit të parë dhe të dytë të vitit 2023, të arriturat, vështirësitë, synimet dhe investimet kapitale. Po ashtu, janë organizuar edhe shumë dëgjime për planifikimin buxhetor për vitin 2024 në qytet dhe në lokalitete të fshatrave në komunën e Klinës dhe për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026.


Gjatë vitit 2023 komuna ka pasur qëllimin e arritjes së këtyre objektivave:

- Administratë publike funksionale në shërbim të qytetarëve;
- Hapje e komunës ndaj qytetarëve;
- Avancimi i së drejtës për informim;
- Pjesëmarrje aktive e qytetarëve në vendimmarrje;
- Ruajtja e hapësirave publike;
- Avancimi i masave kundër ndotjes së ambientit;
- Mbrojtja e lumenjve dhe parqeve;
- Ngritja e kapaciteteve në infrastrukturë;
- Zhvillimi i bizneseve të vogla e të mesme dhe joshja e tyre për investime të reja;
- Subvencionimi në bujqësi;
- Ngritja e treguesve të cilësisë në shëndetësi, arsim, kulturë, rini e sport;
- Llogaridhënia e zyrtarëve ndaj qytetarëve si dhe punë dhe aktivitete të tjera profesionale që dalin nga plani i punës i vitit 2023 dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Realizim të të gjitha projekteve të planifikuara

FILLIMI I
PUNIMEVE PËR
NDËRTIMIN E
SHTËPISË PËR TË
MOSHUAR

**Mbi gjysmë milioni
Investime**





NDRIÇIMI I RI PUBLIK I VENDOSUR PËRGJATË
SHËTITORES SË LUMIT “KLINA”



PROJEKTI PËR RREGULLIMIN E TROTUARIT DHE
ASFALTIMIN E RRUGËS “YMER BERISHA”.



FILLIMI PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT
TË UJËRAVE TË ZEZA NË GLLAREVË





FILLON PROJEKTI PËR NDËRTIMIN E FUNDËRRUESIT
PËR FURNIZIM ME UJË TË PIJES PËR QYTETIN E
KLINËS,

MBI **850 000 €** INVESTIM NGA KOMUNA E KLINËS DHE
KRU HIDRODRINI



SUBVENCIONET NË BUJQËSI NGA KOMUNA:
VLERA MBI **200,000 €** VETËM KËTË VIT



VIZITË ZYRTARE NË QUINTO DI TREVISO NË
ITALI

PËRURIMI I PARQEVE DHE MEMORIALEVE





1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës për vitin 2023 ka realizuar punët sipas Planit të punës së Drejtorisë, duke ofruar shërbime për qytetarë nga të gjitha zyrat me të cilat administron, të specifikuara si më poshtë:

Drejtor: Binak Sylaj

1. SEKTORI I GJENDJES CIVILE DHE REGJISTRIMIT

Nga Sektori i gjendjes civile dhe regjistrimit, në periudhën raportuese janar-dhjetor 2023, janë bërë 1 064 regjistrime të ndryshme: lindjes, martesës dhe vdekjes; janë lëshuar gjithsej 40.599 lloje të certifikatave dhe akte tjera:

- Aplikacione për humbje të shtetësisë, 107;
- Aktvendime për regjistrim të mëvonshëm, ndërrim të emrit dhe mbiemrit, korrigjime, 129.

Nga E-Kiosku janë kryer këto shërbime:

- Certifikata të lëshuara 300;
- Taksa të inkasuara 299,00 €.

Janë inkasuar taksa administrative nga Sektori i gjendjes civile gjithsej 44.316,00 €.

Projektet e përfunduara Kapitale gjatë vitit 2023:

- Ndërtimi dhe rinovimi i objektit të Komunës;
- Vendosja e E-Kioskut, modeli më i ri para objektit të Komunës;
- Rinovimi dhe digjitalizimi në hyrje të objektit të Komunës;
- Rinovimi i sallës së kuvendit Komunal,(kompletimi me mikrofona të rinj).

2. ZYRA E PROKURIMIT

Puna e Zyrës së prokurimit e themeluar në bazë të LPP dhe Organogramit të Komunës, punën e vet e kryen bazuar te LPP 04/L-042 dhe rregulloreve në fuqi mbi Prokurimin publik dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike.

Zyra në afatin ligjor ka bërë planifikimin e PP, i cili është miratuar në Kuvendin komunal dhe është dorëzuar në APP .

Në vitin 2023 kemi iniciuar 161 procedura të prokurimit.

Vlera e tërësishme e buxhetit është 5.652.958.35 € .

Siç parashihet me nenin 9 të LPP është bërë planifikimi i prokurimit dhe i njëjti në bazë të kërkesave të drejtorive është miratuar edhe nga asambleja Komunale që në bazë të llojit janë:

1. Inicime, 178 procedura;

2. Kontrata të lidhura, 161 procedura ;
3. Kërkesa për qasje në dokumente, 29;
4. Kërkesa për rishqyrtim, 32 procedura;
5. Kërkesë për sqarim, 25.

3. ZYRA LIGJORE DHE E PËRFAQËSIMIT

Gjatë vitit 2023, Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit, në bazë të rregullativës ligjore ka kryer dhe përmbushur detyrat dhe përgjegjësit që i ka pasur në kompetencën e saj.

Në kuadër të kompetencës se saj zyra ka kryer përfaqësimin e komunës në të gjitha shkallët e gjyqësorit në nivel vendi, duke përfshirë tërë aktivitetin e përgjegjësive së përfaqësimit, gjegjësisht avokaturës shtetërore.

Përveç përgjegjësive së lartcekur, Zyra Ligjore ishte edhe pjesë e të gjitha debateve dhe takimeve tjera me publikun që ishin mbajtur gjatë periudhës raportuese. Zyra Ligjore, po ashtu, ishte pjesë e seancave të Kuvendit të Komunës.

Më poshtë këtij raporti paraqitet tabelari i lëndëve gjyqësore të aktualizuara gjatë vitit 2023 si dhe më tutje edhe tabelari i seancave të mbajtura gjyqësore gjatë periudhës raportuese. Tabelari dhe krahasimi i lëndëve gjyqësore të aktualizuara-paraqitura gjatë vitit 2023, në raport më të njëjtën periudhë të vitit 2022

I.

II.

Gjithsej numri i lëndëve
në vitin 2023
(Janar-dhjetor)

Vërejtje

485

Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë e sipër te gjykatat kompetente.

Gjithsej numri i lëndëve
në vitin 2022
(Janar-dhjetor)

Vërejtje

Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë e sipër te gjykatat kompetente.

Gjatë vitit 2023 janë aktualizuar 69 lëndë të reja, të cilat lëndë janë në procedim e sipër.

Sa i përket shqyrtimeve gjyqësore dhe seancave gjyqësore të mbajtura te gjykatat e vendit, gjatë tërë vitit 2022 janë mbajtur gjithsej 277 seanca të shqyrtimeve gjyqësore, duke përfshirë ato përgatitore dhe ato të rregullta. Në krahasim me vitin paraprak 2022 që ishin mbajtur 172 seanca gjyqësore, del diferenca që në vitin 2023 janë mbajtur 105 seanca më shumë.

Tabelari dhe krahasimi i seancave gjyqësore të mbajtura gjatë tërë vitit 2023, në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2022

I.	II.
Gjithsej numri i seancave në vitin 2022 (Janar-dhjetor)	Vërejtje
277	
Gjithsej numri i seancave në vitin 2022 (Janar-dhjetor)	Vërejtje
172	

Zyra Ligjore dhe Përfaqësimit, si në vitet e mëparshme ka përfaqësuar komunën edhe në nivelet ministrore sa i përket përfaqësimit të lëndëve konkrete administrative, ku ka lindur nevoja, po edhe këshillimeve përkatëse për të gjitha çështjet juridike. Zyrtarët e kësaj zyre kanë

marr pjesë në takimet e rregullta të kolegjiunit të zyrtarëve ligjor, si dhe takime tjera sipas ftesave përkatëse, në të cilat takime bëhen përpjekjet e unifikimit të veprimeve dhe të gjitha procedurave ligjore në nivel vendi.

Zyra Ligjore, po ashtu, në kuadër të kompetencave të veta gjatë tërë vitit 2023 ka lëshuar edhe akte të tjera juridike, si për Zyrën e Kryetarit të Komunës, po ashtu edhe për tërë Ekzekutivin komunal, si: vendime, kontrata, marrëveshje të ndryshme, autorizime e shkresa dhe akte të tjera të cilat radhiten si në vijim:

Sipas kërkesave për subvencionim me rastin e lindjes së fëmijëve gjatë vitit 2023 janë aprovuar 350 kërkesa me vendime për 350 fëmijë të lindur, nga të cilat, 106 vendime për lindjen e fëmijës së parë; 99 vendime për lindjen e fëmijës së dytë; 91 vendime për lindjen e fëmijës së tretë; 30 vendime për lindjen e fëmijës së katërt; 17 vendime për lindjen e fëmijës së pestë; 5 vendime për lindjen e fëmijës së gjashtë, si dhe; 2 vendime për lindjen e fëmijës së shtatë; ndërsa 1 kërkesë është refuzuar me vendim si e pabazuar. Për kompensimin e shpenzimeve të varrimit gjatë vitit 2023 janë aprovuar 171 kërkesa, ku për këto janë lëshuar 171 vendime si dhe 2 kërkesa janë refuzuar me vendime si të pabazuara. Për ndihmë shëndetësore momentale- subvencionime sipas kërkesave janë aprovuar 102 kërkesa me vendime, si dhe janë hartuar 129 vendime të natyrave procedurale të ndryshme. Në total, gjatë vitit 2023 janë hartuar 754 vendime; 31 kërkesa; 38 autorizime; 42 kontrata; 1 marrëveshje BNK; 1 nismë për BNK; 3 pëlqime; 12 lista; 8 përgjigje; 5 njoftime; 6 ankesa; 3 mendime juridike; 6 fjalë përfundimtare, si dhe disa shkresa përcjellëse.

Për të gjitha kërkesat dhe aktet tjera zyrtare të cilat janë futur në shërbimin e intranetit të Zyra e Kryetarit si të Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit ka menaxhuar me statusin e lëndëve lidhur me vendosjen e tyre nga organet kompetente.

Në kuadër të aktiviteteve tjera ligjore, zyra, po ashtu, ka ofruar të gjitha këshillat e nevojshme dhe të kërkuara nga strukturat tjera të administratës komunale.

Për përfundim mund të konkludojmë se Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit gjatë vitit 2023 ka pasur një aktivitet më të shtuar në përmbushjen e kompetencave ligjore të saja në respektim të ligjit.

4.SHËRBIMI PËR PUNË TË KUVENDIT

Shërbimi për punë të Kuvendit për vitin 2023 ka përgatitur materialin për 11 seanca të rregullta, 1 seancë të jashtëzakonshme dhe 1 seancë solemne, debate me publikun janë mbajtur 5, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë miratuar 85 vendime, 5 Plane të punës nga aktet e miratuara në kuvend pas vlerësimit të ligjshmërisë, 7-janë kthyer në rishqyrtim dhe një

plan veprimi të cilat brenda afatit prej 30 ditësh janë rishqyrtuar në Kuvend dhe janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë.

Janë mbajtur 5 debate me publikun lidhur me konsultimet rreth, KAB 2024-2026, Draft-Buxhetit të Komunës për vitin 2024, Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës. Planin e veprimit për informim dhe komunikim -2023-2026. Shqyrtimi i draft-strategjisë për zhvillim ekonomik, lokal për Komunën e Klinës 2024-2029, Shqyrtimi i draft-planit të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2023-2026 janë shqyrtuar 4 raporte të menaxhimit financiarë, të gjitha vendimet dhe rregulloret janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë në afat të caktuar në MAPL.

Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur 12 (dymbëdhjetë) takime.

Komiteti për Komunitete 11 (njëmbëdhjetë) takime.

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport 1 (një) takim.

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 1 (një) takim.

Komiteti për Shërbime Publike 4 (katër) takime.

Komiteti për Pronë 0 (zero) takime.

Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim 1 (një) takim.

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi (KKSB), 6 takime.

Takime me qytetarët – Kryetari ka mbajtur 2 takime.

5. ZYRA PRITËSE-ARKIVA

Nga Sektori i Zyrës Pritëse, në periudhën raportuese gjatë vitit 2023 ka regjistruar, skanuar dhe evidentuar në librin intern sipas Drejtorive:

1. Drejtoria e Administratës, gjithsej lëndë të regjistruara,	1.226
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, gjithsej lëndë të regjistruara,	65
3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithsej lëndë të regjistruara,	396
4. Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, gjithsej lëndë të regjistruara,	604
5. Drejtoria për Financa, gjithsej lëndë të regjistruara,	830
6. Drejtoria e Arsimit, gjithsej lëndë të regjistruara,	1.731
7. Drejtoria e Bujqësisë, gjithsej lëndë të regjistruara,	2.602
8. Drejtoria e Shërbimeve Publike, gjithsej lëndë të regjistruara,	890

9. Drejtoria e Urbanizmit, gjithsej lëndë të regjistruara,	1.080
10. Drejtoria e Inspektoratit, gjithsej lëndë të regjistruara,	285
11. Shërbimi i Kuvendit, gjithsej lëndë të regjistruara,	343
12. Presidenca, gjithsej lëndë të regjistruara,	1.294
13. Zyra e Prokurimit, gjithsej lëndë të regjistruara,	417
14. Zyra për Kthim dhe Komunitete, gjithsej lëndë të regjistruara,	68
15. Zyra Ligjore,	187

Totali i Lëndëve të regjistruara për vitin 2023 është 12.013 lëndë

Vlera totale e taksave të inkasuara për vitin 2023 është 2.368.62 €

Ky Sektor përpos kësaj janë regjistruar edhe vërtetuar, përshkrime dhe dorëshkrime gjatë kësaj periudhe edhe kërkesa të palëve.

Ky Sektor përpos kësaj që u cek më lartë në regjistrin e vërtetimeve, përshkrimeve dhe dorëshkrimeve gjatë kësaj periudhe ka lëshuar edhe vërtetime, deklarata etj., me kërkesë të klientëve. Në Librin e postës janë regjistruar dërgesa, të cilat janë dorëzuar PTK-së në Klinë. Në regjistrin e postës në vend janë regjistruar shkresa të dala nga KK, të cilat janë shpërndarë në terren, të gazetave zyrtare.

6. ZYRA E INFORMIMIT

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publik, gjatë vitit 2023, në kuadër të komunës së Klinës, i ka mbuluar të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në komunë.

Në vazhdimësi kemi lëshuar komunikata për media për të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në komunën e Klinës, në ueb-faqen e komunës si në facebook. Përmes ueb-faqes, qytetarët janë informuar për çdo ngjarje në kohë. Po ashtu, përmes postimeve të vazhdueshme dhe në kohë në ueb-faqe si dhe në facebook të komunës së Klinës, kemi vërejtur se interesimi i qytetarëve për t'i përcjellë zhvillimet komunale secilin vit është duke u rritur, dhe kemi kërkesa që na drejtohen po nga mesazhet e facebookut, të cilat përcillen tek sektorët përkatës.

Spektori mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre.

Më tej, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun mirëmban ueb-faqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës

dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

Zyra për Informim që nga muaji janar e deri më tani ka arritur të mbulojë në terren rreth 165 ngjarje, që përfshijnë vizita, takime e evenimente të ndryshme të të gjitha dikastereve institucionale të cilat janë shpalosur me kohë për publikun dhe mediat.

Ueb-faqja e Komunës së Klinës mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Faqja zyrtare në internet po mirëmbahet rregullisht dhe po shërben si një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm i informimit për qytetarët e komunës dhe palët tjera të interesuara.

Në periudhën e lartcekur në ueb-faqe janë populluar njoftime, ku shumica prej tyre lidhen me konkurset, thirrjet publike, rezultate, njoftime për programe, lista etj.

Rol të rëndësishëm kanë edhe kërkesat e qytetarëve në Qasjen e Dokumenteve Publike, ku përveç raportit vjetor të “Agjencia për Informim dhe Privatësi”, raportin e protokolluar e plasoj edhe në ueb-faqe të komunës.

Kur jemi te raporti i fundit në Qasjen e Dokumenteve Publike, gjatë periudhës janar – dhjetor 2023 janë gjithsej 36 kërkesa, ku 34 kanë marr përgjigje, ndërsa 2 janë pa përgjigje.

Raporti është punuar sipas Ligjit mbi Qasjen e Dokumenteve Publike i cili është në fuqi.

Gjatë vitit 2023 Zyra për Informim në Komunën e Klinës ka marr përgjegjësi shtesë, ku përveç vendimeve të kryetarit të komunës që zyrtarja Vlora Tafili është caktuar si Zyrtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe Zyrtare përgjegjëse për Koordinimin e Konsultimeve Publike, duke organizuar 3 konsultime publike, 17 dëgjime buxhetore si dhe 5 diskutime me publikun.

Gjithashtu, me vendim të kryetarit të komunës, Zyra për Informim ka hartuar edhe PLANIN E INTEGRITETIT 2024-2026.

Në qershor të vitit 2023, në bashkëpunim me OSBE-në është hartuar STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN 2023 – 2026, si dhe PLANI VJETOR I VEPRIMIT PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2023-2026.

Zyra për Informim ka luajtur një rol të rëndësishëm sa i përket mbledhjes dhe raportimit të të dhënave në Raportin e Performancës Komunale 2022, duke përmbushur tre kategori me mbi 60 të dhëna.

Në avancimin tutje të transparencës komunale, Zyra për Informim ka dhënë 7 rekomandime, tashmë të realizuara e të cilat do të luajnë një rol poentues në raportin e performancës si dhe raportin e përmbushjes së obligimeve të komunës ndaj agjendës evropiane.

Sfidë mbetet mungesa e burimeve njerëzore në Zyrën për Informim si dhe nevoja për t'u

trajnuar në fushat e marketingut digjital, mbi përdorimin efikas të platformave sociale (FB, Instagram, YouTube), për personelin në ZIMP, për mobilizim dhe aktivizim të audiencës në formatet më bashkëkohore.

7. NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZBGJ

Zyra për Barazi Gjinore gjatë vitit 2023 është preokupuar në realizimin e plotë të punëve të planifikuara dhe mund të konstatojmë se ka qenë një vit shumë i suksesshëm, ku janë realizuar dhjetëra punëtori, tryeza dhe takime të ndryshme të organizuara nga:

1. Më datë 14.03.2023 punëtori njëditore nga OSBE-ja;
2. Më datë 16.03.2023 punëtori Advacing Together (AT) ku në takim morën pjesë zyrtarët e Komunave, Klinë, Pejë, Gjakovë, Deçan dhe Junik;
3. Më datë 24,25,26.04.2023 punëtori treditore organizuar nga UN-ËOMËN;
4. Më datë 22,23.05.2023 punëtori dyditore organizuar nga OSCE;
5. Më datë 25,26.05.2023 punëtori dyditore organizuar nga Zyra e Kryeministrit;
6. Më datë 30.08.2023 tryezë e rrumbullakët e organizuar nga HUMAN KOSOVA;
7. Më datë 06.09.2023 tryezë e rrumbullakët e organizuar nga CERi;
8. Më datë 13.09.2023 punëtori e organizuar nga IOM-i në bashkëpunim me MPB-në;
9. Më datë 29.09.2023 punëtori organizuar Asociacioni i Komunave të Kosovës;
10. Më datë 16.10.2023 hapja e fushatës për ndërgjegjësim kundër kancerit;
11. Më datë 25.10.2023 Agjencioni për Barazi Gjinore mban trajnim njëditor me punëtorë të Administratës;
12. Më datë 09.11.2023 tryezë e rrumbullakët e organizuar nga MAPL-ja;
13. Më datë 22.11.2023 është bërë hapja e qendrës së angazhimit për Komunitete;
14. Më datë 24.11.2023 ZBGJ-ja në Klinë organizon tryezë me fondacionin Jahjaga;
15. Më datë 26.11.2023 takim për hapjen e fushatës 16-ditore kundër dhunës në familje;
16. Më datë 30.11.2023 u mbajtën aktivitete vetëdijesuese kundër dhunës në baza gjinore;
17. Më datë 19.12.2023 është mbajtur takimi për hartimin e Strategjisë Komunale kundër dhunës në familje.

Qëllimi i ZBGJ-së ishte promovimi i të drejtave të barabarta të grave dhe dhuna në familje; Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit kundër dhunës në familje; Ngritja e vetëdijes për dhunë në familje; Mbështetja e infrastrukturës për mbrojtjen dhe integrimin e viktimave të dhunës; Nxitja dhe vetëdijesimi i grave-vajzave mbi të drejtën e trashëgimisë; Aktivitetet për shënimin e Ditëve Ndërkombëtare, etj,. Të gjitha aktivitetet janë bërë në Koordinim me ABGJ-në, Drejtoritë Komunale, Shoqëritë Civile dhe OJQ- të.

8. ZYRA KOMUNALE PËR INTEGRIME EVROPIANE

Duke u mbështetur në bashkëpunimin shumë të mirë me stafin e administratës së Komunës së Klinës, koordinimin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin, janë përmbushur në vazhdimësi obligimet që kam si zyrtare për IE.

Në janar kam punuar Raportin vjetor të punës të ZKIE për vitin 2022 i cili i është dërguar drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

Në shkurt ua kam përcjell të gjithëve në strukturën udhëheqëse në Komunë Draft-Raportin e përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën janar – dhjetor 2022. Raporti ishte i përmbledhur dhe i punuar nga MAPL –Divizioni për Integritet Evropiane. Në dokument janë aktivitetet të cilat janë përmbushur si dhe rekomandimet për aktivitetet që duhen adresuar.

Po ashtu, në dokumentin e bashkangjitur me emërtimin “Rekomandimet” i kam veçuar aktivitetet të cilat duhet adresuar, nga ato të përmbushura.

Në mars, Asociacioni i Komunave të Kosovës në kuadër të koordinimit të objektivave dhe aktiviteteve, ka organizuar takimin e radhës të Kolegjiut për Integritet Evropiane në diskutimin e temave dhe çështjeve të adresuara nga autoritetet lokale, në kuadër të veprimtarisë në fushën e procesit të integritetev evropiane në Komuna.

Në qershor kam filluar me komunikimet dhe mbledhjen e të dhënave për raportin gjashtëmuor si dhe hartimin e raportit për përmbushjen e obligimeve të Komunës nga Agjenda Evropiane për periudhën janar – qershor 2023.

Ne fund të qershorit kam përcjellë Raportin e Komunës së Klinës për periudhën janar-qershor 2023, MAPL-së si dhe të gjithëve në strukturën udhëheqëse në Komunë.

9. ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Gjatë vitit 2023 janë kryer punët si në vijim: Është përkrahur stafi i administratës së Komunës së Klinës në aspektin e teknologjisë informative, duke përfshirë intervenime në pajisjen e TI-së si kompjuterë, printerë, monitorë, dhe pajisje tjera periferike për të mbarvajtur punët në normalitet, të jenë sa më efikas për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Shërbimi i IT-së ka bërë instalimin e kompjuterëve të rinj të cilët janë blerë nga administrata

përgjatë vitit 2023 duke instaluar softuer të nevojshëm me konfigurimet e nevojshme konform udhëzimeve administrative dhe ligjeve në fuqi, si dhe ku ka qenë e nevojshme i janë bartur shërbimet nga pajisjet e vjetra në pajisjet e reja. Në këtë pikë konsideroj që Komuna e Klinës e ka të nevojshme që të ngreh kapacitetet e pajisjeve të IT-së sidomos për kompjuterë ku në disa shërbime ka kompjuterë që janë aktivë duke punuar rreth 10 vite dhe me rekomandimet nga Microsoft për të kaluar në sistemet e fundit operative, pasi që tani edhe Eëindoës 7 dhe 8.1 nuk ka më support është e pamundur që të realizohet një gjë e tillë pa blerjen e kompjuterëve të ri dhe kjo është e nevojshme që rreth 15% e kompjuterëve të zëvendësohen me të ri. Në fillim të kësaj periudhe janë gjëndëruar raportet nga sistemi i intranetit për lëndët të cilat janë gjëndëruar nga sistemi si dhe nga ky shërbim është bërë edhe raportimi për MAPL-në në tre indikatorët e parë të vlerësimit të performancës, ka krijuar të gjitha llogaritë për stafin e ri të Komunës së Klinës si dhe me kërkesë të personelit janë pasvizuar llogaritë e zyrtarëve që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës ose janë pensionuar. Është gjëndëruar kërkesa për certifikatën SSL për E-Kioskun e cila certifikatë është lëshuar nga ASHI për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Sistemit të Gjendjes Civile në ARC dhe E-Kioskut të Komunës së Klinës.

Serveri me Eëindoës server 2008R2 në versionin standard është bërë Upgrade në Versionin Eëindoës Server 2012R2 Standard, pasi që më nuk ka përkrahje versioni i vjetër, si dhe janë bërë të gjitha përditësimet e sistemeve të brendshme që ofrojnë shërbime për qytetarët dhe për stafin komunal në përputhje me udhëzime administrative nga agjencioni i shoqërisë së informacionit si dhe rekomandimet e prodhuesve.


Po ashtu, gjatë këtij viti është bërë edhe përkrahja në aspektin teknik për Zyrat e Gjendjes Civile në terren ku janë bërë intervenime në distanca por në bazë të nevojave është bërë edhe intervenim lokal që të jenë funksionale të gjitha zyrat, si në aspektin e lidhjeve VPN, po ashtu edhe në funksionalitetin e pajisjeve si kompjuterë, monitorë, printerë, fotokopjues dhe skanerë.

Është funksionalizuar Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Kërkesave në SEMS dhe janë regjistruar kërkesat që kanë të bëjnë me zyrën e IT-së. Tiketa të hapura gjatë këtij viti janë 297 tiketa të cilat janë zgjidhur, që nënkupton intervenime në infrastrukturë të TI-së si në rrjet, serverë, administrim të sistemeve dhe pikat fundore që përfshihen kompjuteri, printer, skaner dhe pajisje tjera periferike.

Statistics

Statistics of tickets organised by department, help topic, and agent.

Range: January 1, 2023 - December 21, 2023 (Europe/Berlin)

Departmenti	Topics	Agjenti				
Departmenti	Të Hapura	Caktuar	Overdue 	Të mbyllura	E rihapur	E fshirë
Komuna Kline	297	297	23	298	1	0

Gjatë këtij viti është përkrahur zyra e informimit për publikimin e materialeve në ueb-faqe çdoherë kur është paraqitur nevoja për ndihmën e shërbimit të IT-së.

Ka përgatitur sallën e Kuvendit për seancat e rregullta të kuvendit në aspektin e Teknologjisë Informative, në fillim të 6 mujorit të dytë është avancuar sistemi i Audios në sallën e kuvendit duke i zëvendësuar mikseten dhe mikrofonat e vjetër më të ri si dhe shtimin e tyre duke përmbyshur nevojën për të gjithë anëtarët e kuvendit dhe ekzekutivin. Kjo është realizuar në bashkëpunim me drejtorin e Administratës dhe Shërbimin e Kuvendit, si dhe punë të tjera me kërkesë nga eprori që kanë ndërlidhje me Teknologjinë Informative.

10. ZYRA E PRANIMIT TË MALLIT

Nga ky Sektor është kryer puna e pranimi të mallit, të gjitha hyrjet dhe daljet e materialeve shpenzuese dhe kompjuterëve, printerëve, fotokopjeve e materiale tjera shpenzuese, gjithashtu janë kryer edhe raporte të pagesave në free-balance.

11. ZYRA E PËRKTHIMEVE

Është përgjegjës për punët në lëmin e përkthimeve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;

Gjatë vitit 2023 kjo Zyrë ka zhvilluar gjithsej:

- Njoftime (Kuvendi, Komiteti i Komuniteteve, KKSB dhe komiteteve tjera 70 (135 faqe)
- Vendime të Kuvendit Komunal 70 (140 faqe)
- Ftesa për debate të ndryshme Publike 10 (20 faqe)
- Procesverbale të takimeve të ndryshme 90 (450 faqe)

- Konkurse
24 (50 faqe)
- Kërkesa, vërtetime, Plane Pune-Vepimi, strategji
85 (250 faqe)
- TOTAL 360 (1030 faqe A4)

Përveç të cekurave, janë bërë përkthime në takime të ndryshme si p.sh., në takimet e Komitetit të Komuniteteve (11), KKSb-së (6), takime me OJQ dhe me Komunitete (10).

Në total, në takime të tilla janë rreth 110 orë përkthimi.

12. ZYRA E PERSONELIT

Gjatë vitit 2023 kjo Zyrë ka zhvilluar gjithsej:

- | | |
|---|------------|
| • Konkurse, procedurë e brendshme | 18 |
| • Procedurë në zhvillim e sipër | 5 |
| • Konkurse të jashtme, procedura të përfunduara | 13 |
| • Vendime për pushime vjetore, janë lëshuar | 156 |
| • Ankesa në KPMSHCK | 6 |
| • Përgjigje në ankesë KPMKSHC-së | 6 |
| • Raporte për të rregullta MPB sipas kërkesave | |
| • Janë miratuar gjithsej | 1873 lëndë |
| • Vendime për ndërprerje vullnetare të punës | 3 |
| • Vendime për ndërprerje të punës (Pensionim) | 10 |
| • Trajnime të zhvilluara | 22 |
| • Vendime për pushime të lehonisë | 2 |
| • Vendime për pezullim vullnetar | 2 |
| • Vendime për pezullim sipas detyrës zyrtare | 2 |
| • Në vazhdimësi është bërë digjitalizimi i dosjeve personale të nëpunësve, | |
| • Janë përgatitur dhe publikuar në HRMS të gjitha konkurset nga Drejtoria e Arsimit dhe Shëndetësisë, | |
| • Kemi marrë pjesë në trajnimet e Forumit të menaxherëve në nivel vendi. | |

13. SEKTORI TEKNIK – LOGJISTIKA

Nga ky Sektor gjatë vitit 2023 me sukses janë kryer: Ruajtja e Objektivit të Komunës,

organizimi i punës me palë, mirëmbajtja e pastërtisë, mirëmbajtja e ngrohjes, përcjellja e shpenzimeve të derivateve, mirëmbajtja e veturave zyrtare, përcjellja e shkresave për organe dhe palët dhe punë tjera sipas nevojës.

14. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Për periudhën raportuese për vitin 2023, sipas Planit të punës të NjAB, kanë qenë të parapara 4 (katër) auditime të cilat janë zhvilluar në disa njësi organizative – Drejtori në kuadër të Ekzekutivit të Komunës.

Këto auditime janë kryer që të gjitha në pajtueshmëri me planin e aprovuar vjetor të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023, krejt kjo në bazë të nevojave reale dhe gjendjes së analizuar nga Auditorët, Komiteti i Auditimit dhe menaxhmenti i Komunës, që si qëllim parësor kanë mbështetjen e organeve të Administratës së nivelit komunal, zhvillimin dhe fuqizimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të financave publike në komunë.

Gjatë vitit 2023 nga Njësia e AB, janë realizuar auditimet dhe punët si në vijim:

1. Shpenzimet për ngrohje në Drejtorinë e Arsimit dhe në shkolla për vitin 2022;
2. Menaxhimi i automjeteve zyrtare të Administratës komunale dhe të Shëndetësisë;
3. Të hyrat nga Gjeodezia, Kadastra dhe Pronësia;
4. Subvencionet nga Drejtoria e Kulturës 2023;
5. Menaxhimi i pronave publike në shfrytëzim të bizneseve: hapësirat publike, parkingjet, reklamat;
6. Shpenzimet për investime kapitale 2023.

Nga auditimet e përfunduara për vitin 2023, gjendja statistikore e objektivave, të gjeturave dhe rekomandimeve është kjo.

- Janë përcaktuar 21 objektiva të shpërndara në 6 auditimet e përfunduara.
- Të gjeturat nga auditimet e përfunduara për vitin 2023 janë 46 , këto të gjetura janë vlerësuar si rrezik për funksionim të sistemit në temat të cilat kanë qenë të audituara.
- Nga auditimet e përfunduara janë dhënë 31 rekomandime, me qëllim të përmirësimit të gjeturave dhe punës nga subjektet e audituara.

Krahas auditimeve të përfunduara nga NjAB janë kryer edhe punë tjera si:

- Përgatitja e Planit Strategjik për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për periudhën trevjeçare 2024- 2026.
- Përgatitja e Planit vjetor për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024.

- Përgatitja e 6 Planeve të auditimit të punës për secilin auditim të veçantë, me formularët e duhur përcjellës.
- Përgatitja e raporteve 6 mujore dhe raportit vjetor të punës për NjQHAB dhe Kryetarin e Komunës.
- Përgatitja e 6 Planeve të Veprimit të Menaxhmentit për implementimin e rekomandimeve.
- Përgatitja e Orareve përcjellëse të rekomandimeve për monitorim nga auditimi i brendshëm për të gjitha auditimet e përfunduara për vitin 2023.
- Mbajta e takimeve të rregullta me Komitetin e Auditimit .
- Bashkëpunimi me Auditorët e jashtëm rreth punës së NjAB dhe ofrimi i shënimeve të cilat janë kërkuar nga ana e tyre.
- Përcjellja e trajnimeve që kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm, që është obligative, që të mund të ushtrohet puna e Auditorit dhe për vazhdimin e licencimit.
- Konsultime me menaxhmentin lidhur me auditimet.
- Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për menaxhmentin dhe sektorët e veçantë.
- Konsultime profesionale me NjQHAB.
- Janë kryer edhe konsultime duke dhënë rekomandime gojore tjera me Ekzekutivin dhe punëtorët e administratës sipas nevojës dhe kërkesave.

15. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Gjendja e Sigurisë gjatë vitit 2023 :Sa i përket gjendjes së sigurisë janar – dhjetor 2023 në Komunën e Klinës, lëvizja e qytetarëve është e lirë dhe në nivel të kënaqshëm, nuk ka asnjë eksese në lëvizjen e lirë të komuniteteve pakicë në Komunën e Klinës.

Përveç këtyre, Zyra ka kryer punët e saj të përditshme në terren si dhe përcjelljen e gjendjes dhe nevoja të të kthyerve si dhe punët brenda Zyrës.



**2. DREJTORIA PËR
KADASTËR, GJEODEZI
DHE PRONËSI**

Drejtor: Nikson Daka

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi

Punët të cilat realizohen në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës raportohen çdo vit.

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi gjatë vitit 2023 ka funksionuar me stafin si në vijim:

- Zyrtarët për pranimin e qytetarëve,
- Zyrtarja përgjegjëse për regjistrim në RDPP,
- Asistenti administrativ,
- Zyrtari për shërbim pronëso- juridik,
- Gjeodetët.

Disa nga punët të cilat janë kryer në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës gjatë vitit 2023 janë:

1. Rritja e stafit punues (gjeodet dhe jurist).
2. Informimi me kohë i qytetarëve për miratimin apo refuzimin e kërkesave të tyre drejtuar për Drejtorinë e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë.
3. Mbajtja tabelare e raportit financiar të pagesave mujore të realizuara nga gjeodetët, zyrtarja përgjegjëse dhe zyrtaret në sportel në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
4. Përfundimi i kërkesave të papërfunduara të gjeodetëve të licencuar. Kryerja e lëndëve të legalizimit të shtëpive, objekteve dhe lokaleve në geoportal.
5. Ofrimi i shërbimeve në rast nevojë për matjet në terren me kërkesë të drejtorive të tjera të cilat operojnë në Komunën e Klinës.
6. Menaxhimi i lëndëve në Intranet, miratimi apo refuzimi i tyre.
7. Vlerësimi i pronave të shpronësuara.
8. Këmbimet në ZK Klinë dhe ZK Dresnik, duke marrë parasysh interesin e përgjithshëm publik.

Raporti sipas departamentit dhe statusit të zgjidhjes

01.01.2023-31.12.2023, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi

<u>Shkurtesa</u>	<u>Pranuar</u>	<u>Në Procës</u>	<u>Miratuar</u>	<u>Refuzuar</u>	<u>Hedhur Poshtë</u>	<u>Pezulluar</u>	<u>Anuluar</u>	<u>Përfunduar</u>	<u>Totali</u>
DKGJP	22	1230	2866	31	3	7	33	0	4192

Pra, siç shihet në tabelë gjatë periudhës njëvjeçare, janar – dhjetor 2023, në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi kanë arritur 4192 kërkesa të ndryshme përmes sistemit të intranetit, mirëpo në këto nuk janë të përfshira kërkesat për certifikata të pronësisë nga rastet sociale, më pas kërkesat nga prokuroria, policia, të cilat nuk janë të përfshira në sistemin intranet.

GJATË VITIT 2023 NË DREJTORINË PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI, KONSTATOJMË SE:

Janë lëshuar **3171** certifikata të pronësisë me pagesë nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar **27** certifikata që pala nuk posedon pronë me pagesë nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar **2000** kopje të planit me pagesë nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar **1105** certifikata të pronësisë pa pagesë për raste sociale nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar **633** certifikata të pronësisë pa pagesë zyrtarisht nga zyrtarët përgjegjës

Janë lëshuar **20** kopje të planit pa pagesë zyrtarisht nga zyrtarët përgjegjës

-Ndërsa në bazë të kërkesave siç janë të gjeodetëve të licencuar, qoftë për ndarje-bashkim të parcelave, legalizimeve, vendosje në sistem të parcelave, historiatet, ekspertiza, aktvendime, marrëveshje të plotfuqishme të gjykatave ose organeve të tjera kompetente në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi kanë arritur gjithsej **695 kërkesa**.

-Ndërsa tek zyrtarja përgjegjëse për regjistrimin dhe modifikimin e të dhënave në RDPP kanë arritur gjithsej **1266 lëndë** dhe janë nxjerrë vendimet për secilën prej tyre ku përfshihen kryesisht kontratat noteriale, lëndët e gjeodetëve dhe vendimet e gjykatës.

-Përveç këtyre punëve të cilat janë kryer gjatë vitit 2023 në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi. gjatë këtij viti janë pranuar edhe tri kërkesa për ndërrim destinimi të tokës të cilat janë bërë me pëlqimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

-Për nevoja të ndryshme të qytetarëve, përveç trajtimit të kërkesave të ndryshme të cilat janë bërë, dhe për secilën prej tyre pasi që janë kthyer përgjigje janë ofruar edhe shërbimet, siç janë: lëshimi i certifikatave të pronësisë, certifikatave për social dhe lëshimi i certifikatës që nuk posedon pronë, më pas shërbimet nga gjeodetët si identifikimin e parcelave, lëshimi i kopjeve të planit, matjet për nevoja komunale, dhe me kërkesë të Gjykatës, Prokurorisë dhe Policisë,

më pas sigurimi i hartave Orto – foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, dhe ofrimi i shërbimeve përmes modelit të sistemit informativ mbi tokën dhe pronën, më pas bartja e pronësisë në bazë të dokumenteve valide ligjore dhe të verifikuara si nga noteri, gjykata, dhe vendimet tjera të organeve administrative.

RAPORTI PËRMBLEDHËS I TË HYRAVE BUXHETORE PËR VITIN 2023 SIPAS MUAJVE

01.01.2023-31.12.2023, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
3010	3786	7092	4575	5368	3904	2368	5830	5990	6110	5110	5890
euro	euro	euro	euro	euro	euro	euro	euro	euro	euro	euro	euro

Të hyrat vjetore në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, nga zyrtarët në sportel, gjeodetët dhe zyrtarja përgjegjëse për regjistrim në RDPP janë: 79 725 Euro.



3. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoreshë: Fatjona Gashi

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Ka realizuar me sukses planin vjetor të punës për periudhën janar-dhjetor 2023, duke realizuar kështu një numër të madh aktiviteteve e punë të parapara sipas kategorisë së departamenteve me të cilat udhëheqë kjo drejtori, duke shënuar kështu edhe rezultat të mirë në shpenzimin e buxhetit të paraparë për këtë vit në të gjitha kategoritë shpenzuese.

- **ARKIVI HISTORIK**

Në vazhden e punëve për sistemimin e lëndës arkivore është punuar në rregullimin e materialit arkivor të disa fondeve.

Fondet e rregulluara

Emri i Fondit	Vitet	Lëndë gjatësi	Nr. kutive, librave	Nr. faqeve
Biblioteka e qytetit "Kongresi i Manastirit"		1.5 m	3 kuti 6 libra	4879
SHFMU " Nënë Tereza" Budisalc	1977- 1990	8 m	400 libra (ditarë pune)	
				Gjithsej metra: 9.5 m

Krahas punës në rregullimin e lëndës arkivore, prioritet për arkivin ka qenë puna me palë, pranimi i kërkesave dhe shqyrtimi i tyre.

Numri i kërkesave

Kërkesa të pranuar	Të realizuara	Të parealizuara për shkak të mungesës së lëndës në arkiv	Kopje A3 të lëshuara	Kopje A4 të lëshuara
168	128	40	211	494

Këtë vit nga DKRS ka filluar implementimi i projektit trevjeçar për ndërrimin e rafteve në arkiv. Janë montuar 60 raftet të sistemit modular sipas standardeve arkivore që ofrojnë siguri në ruajtjen e dokumenteve për periudha më të gjata. Është punuar në zhvendosjen e lëndës arkivore në raftet modulare, ku janë zhvendosur gjithsej 80 m lëndë. Gjithashtu është punuar në procesimin e të dhënave në PC të lëndës arkivore që gjendet në depo. Janë vendosur të dhëna të detajuara në PC të 46 kutive të fondit nr. 20, Bashkësia Themelore e Punës Sociale e Klinës.

- **BIBLIOTEKA E QYTETIT "KONGRESI I MANASTIRIT"**

Duke u bazuar në planifikimin e punës për këtë vit, kemi realizuar shumicën e punëve të

planifikuara me pasurimin e fondit librar, përpunimin e librit dhe regjistrimin e librit, mbajtjen e evidencës së lexuesve, kërkesat e vazhdueshme me lexues për ruajtjen dhe kthimin e librit në bibliotekë, pastaj mbajtjen e orëve letrare etj. Me fillim të vitit stafi është plotësuar edhe me 2 zyrtarë -bibliotekistë, duke bërë kështu më lehtë të realizueshme punën në bibliotekë.

Biblioteka "Kongresi i Manastirit", me vendim të drejtoreshës për të ndihmuar themelimin e bibliotekës shqipe në Manastir dhe për të ju përgjigjur kësaj nisme, dhuroi një sasi librash (të cilat kanë qenë jashtë përdorimit për lexues) në depo, me gjithsej 246 ekzemplarë nga fondi librar.

Më 23.02.2023 kemi nënshkruar memorandum me MKRS-në, përmes ministrit z. Hajrullah Qeku për financimin e Bibliotekës për blerjen e librave në vlerë prej 6451.00 euro. Nga libreria "BUZUKU" sipas memorandumit dhe sipas kërkesave tona jemi furnizuar me 760 ekzemplarë, me 227 tituj, ku në këtë sasi ka edhe 8 libra të alfabetit brajt (furnizuar për herë të parë duke ofruar mundësi leximi edhe për personat e verbër) si dhe 45 tituj në gjuhën serbe, të përcaktuara në memorandum. Lexuesit janë njoftuar vazhdimisht përmes faqeve zyrtare dhe medieve lokale si dhe përmes orëve letrare të mbajtura kohë pas kohe. Këtë vit numri i lexuesve ka qenë 403 gjithsej, ndërsa furnizimi me libra për vitin 2023 ka qenë 1029 ekzemplarë, me gjithsej 324 tituj. Si staf vazhdojmë të angazhohemi edhe në ruajtjen e këtyre ekzemplarëve duke mbajtur evidenca dhe raporte të vazhdueshme për huazimin dhe kthimin e librave nga lexuesit.

• ZYRA PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Zyra për trashëgimi kulturore ka arritur me suksese t'i përmbush shumicën e objektivave dhe aktiviteteve të parapara në planin vjetor të punës. Në vitin 2023 kemi arritur bashkëpunime ndërinstucionale me të gjitha institucionet varëse të trashëgimisë kulturore si: QRTK, Instituti Arkeologjik i Kosovës, KKTK, Muzeu e Kosovës, OJQ të ndryshme etj.

Objektiva kryesore e këtij viti ishte inventarizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në Komunën e Klinës, ku me vendim të kryetarit të komunës është formuar komisioni komunal për realizimin e kësaj objektive. Pas tre muajsh punë të suksesshme në terren kemi arritur që të përgatisim listën me disa objekte dhe t'i propozojmë përmes QRTK-së, për përfshirje në "Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme" sipas kriterëve të kërkuara dhe Ligjit Nr.02/L-88. Në tetor të vitit 2023 komisioni ministror ka vendosur në "Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme" katër objekte të Komunës së Klinës: Tri (3) kulla dhe një mulli të cilat kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit komunal.

Gjatë këtij viti ka filluar edhe implementimi i projektit “ Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë”, “Udhëtimi në Kohë” i cili financohet nga Bashkimi Evropian, me CDF si lider dhe partner kryesor Komunën e Klinës dhe ka për qëllim të kontribuoj në përmirësimin dhe zhvillimin e turizmit dhe promovimin e trashëgimisë. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e Institutit Arkeologjik kemi mbajtur disa takime me pronarët e parcelave në fshatin Dresnik me të cilët është arritur marrëveshje bashkëpunimi, proces ky që vazhdoi edhe në kuadër të MKRS-së të cilët kanë aprovuar tashmë edhe procesin e shpronësimit të plotë në mënyrë që Qyteti Antik të zhvillohet.

Një rëndësi të veçantë i kemi kushtuar edhe promovimit të trashëgimisë duke realizuar aktivitete të ndryshme promovuese, vendorë dhe të huaj.

Sfiduese gjatë këtij viti ishte realizimi i draft-strategjisë komunale të trashëgimisë kulturore si dhe guida turistike për promovimin e saj e cila mbetet për t'u realizuar në vitet e ardhshme.

• ZYRA PËR KULTURË

- Sektori i kulturës gjatë vitit 2023 ka realizuar mjaft aktivitete kulturore nga plani i punës së DKRS-së por edhe bashkëpunime me institucione e personalitete të tjera.
- **Shkurt** - Ora Letrare e Pavarësisë dhe Promovimi (homazh) letrar i librit të Skënder Rracaj “Dëshiroja të ulërija në vetmi”, ekspozitë personale e piktorit Demush R. Avdimetaj, program artistik me këngë e valle.
- **22 Shkurt** - Koncerti lëvizës i Filarmonisë së Kosovës me Orkestrën Frymore.
- **Prill** - Ekspozita kolektive e nxënësve të Shkollës së Mesme të Arteve Aplikative “Odhise Paskali” Pejë.
- **4 Prill** – Dita e të pagjeturve, akademi përkujtimore dhe ekspozitë e kujtesës kolektive.
- **22 Maj** - Dita e teatrit të Klinës - U përkujtua Osman R.Gashi dhe u ndanë mirënjohje për aktorët dhe regjisorët që kontribuan në zhvillimin e teatrit gjatë viteve 1970- 1990. U shfaq edhe premiera e dramës “Nëna” me autore Vlora Gashi dhe regjisor Alban Gashi.
- **6, 7, 8 Qershor** – Festivali Folklorik “I këndojmë lirisë” - i realizuar për tri ditë me radhë në Çabiq dhe Klinë, netët artistike me pjesëmarrje masive nga ansamble e grupe folklorike nga të gjitha trevat shqiptare e me gjerë.
- **18 Qershor** – Dita e Çlirimit të Klinës, Ekspozitë kolektive e artistëve figurativ të Klinës si dhe Programi artistik me këngë e valle dhe recitale.
- **26.06.2023** u mbajt Takim Ndërkulturor Letrarë.
- **Më 21 - 25 Korrik** u mbajt “Camping Fest” edicioni i 5-të në Dresnik, Ujmirë- Klinë, e organizuar nga OJQ “ArtEko” e mbështetur në Komuna Klinë - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Camping Fest promovon: Trashëgiminë kulturore, zhvillimin e turizmit lokal,

afirmimin e vlerave kulturore, promovimin e prodhimeve vendore etj.

- **Dita e diasporës** - 30 Korrik me mbrëmje muzikore.
- **Më 7 Shtator** u organizua manifestimi tradicional, "Ora e Tahir Deskut" i 14-ti me radhë, ku u shpërblye vepra më e mirë letrare dhe u nda Çmimi "Tahir Desku".
- **Më 2 Tetor** filloi kursi i pikurës me nxënës, realizuar nga Taulant Berisha.
- **Më 13 – 17 Nëntor** u mbajt Java e Kulturës, edicioni i dytë, në bashkëpunim me Fakultetin e Arteve të Prishtinës dhe të Pejës ku u dha program artistik me ekspozitë figurative, koncert kuartet, debat ndërkulturor, filma te metrazhit të shkurtër dhe promovime letrare.
- **27 Nëntor** - Ekspozita tradicionale "ART Klina" 2023 -Edicioni i tetë.
- **8 Dhjetor** – "ArtPolis" në bashkëpunim me DKRS- në shfaqjen Forum Teatër.

• **ZYRA E PËRGJEGJËSIT PËR ZËRIM DHE KINOAPARATURË**

I është përgjigjur secilit aktivitet kulturor, rinor e sportiv në kuadër të DKRS-së sipas kërkesave institucionale. Por, veç kësaj edhe aktivitete kulturore, politike e shoqërore të realizuara në bashkëpunim me shoqërinë civile për të cilët ka qenë e nevojshme salla për ta përcjellë me të gjitha pajisjet dhe përgatitjet e tjera teknike përreth 30 aktiviteteve gjithsej brenda vitit.

• **ZYRA PËR RINI DHE SPORT**

Gjatë vitit që lamë pas kemi pasur takime të vazhdueshme në departamentin e rinisë në kuadër të MKRS-së, me organizata rinore si dhe punëtori që kanë për qëllim angazhimin e rinisë në projekte të ndryshme. Kemi zhvilluar aktivitete të shumta kulturore, sportive dhe rinore duke promovuar kështu punën vullnetare, ambiciet dhe fuqizimin e rinisë. Si përmbyllje e programit UP TO YOUTH – USAID sipas marrëveshjes së bashkëpunimit kemi realizuar shumë takime ndër-komunale për të parë mundësitë e aktivizimit dhe bashkëpunimit rinor. Gjatë muajit tetor kemi realizuar Javën e Rinisë me aktivitete të ndryshme në art, letërsi, sport, sesione informuese me interes të veçantë për sigurinë e rinisë, trajnime etj.

• **SPORT**

Zyra për sport në koordinim me zyrën për kulturë dhe rini, ka zhvilluar vazhdimisht aktivitete sportive për shënime të datave me rëndësi historike duke ndihmuar kështu edhe në promovimin e sportit tek të rinjtë por duke ju qëndruar afër edhe klubeve sportive. Gara të ndryshme janë mbajtur edhe në disa shkolla duke aktivizuar kështu edhe sportin shkollor. Mbështetja financiare e klubeve nuk ka munguar as këtë vit përmes thirrjes publike dhe klubet kanë vazhduar me programet e tyre me pjesëmarrje në gara duke realizuar suksese për komunën tonë.



**4. DREJTORIA E BUJQËSISË,
PYLLTARISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**

Drejtor: Lorenc Marleku

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Me fillimin e vitit 2023 është bërë Plani i punës në bazë të të cilit Drejtoria e Bujqësisë do t'i kryejë të gjitha punët dhe aktivitetet e saj.

Ne si Drejtori e Bujqësisë, përveç planit tonë të punës kryejmë edhe detyra që dalin nga Ministria e Bujqësisë e veçanërisht aplikimi i fermerëve për subvencionim, raportimin për realizimin e mbjelljeve të kulturave bujqësore, korrije-shirjeve, ndërrimi i kulturës bujqësore, nga tokë pyjore në tokë bujqësore (sipas kërkesave të fermerëve), raportimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore etj.

Më datën 12.01.2023 ka filluar aplikimi i fermerëve për subvencionimin e qumështit për sasi dhe majmëri të viçave që mbështet nga Ministria e Bujqësisë. Ky aplikim ka zgjatur deri më 11.02.2023 e që është për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2022.

Duke pasur parasysh se mbjelljet pranverore fillojnë herët në pranverë, ne paraprakisht si drejtori kemi përgatitur planin e mbjelljeve pranverore dhe njëkohësisht kemi këshilluar fermerët që t'i aplikojnë të gjitha masat agroteknike si dhe të përdorin farëra cilësore dhe të certifikuara.

Ketë plan po e paraqesim edhe formë tabelore për vitin 2023:

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara ha	Sipërfaqet e realizuara ha
1.	Misër	2985	2975
2.	Tërshërë	255	250
3.	Perime	205	203
4.	Patate	145	150
5.	Bimë foragjere	780	785
6.	Të tjera	90	85
	Gjithsej	4460	4448

Siç shihet nga tabela, plani i mbjelljeve pranverore është realizuar pothuajse në tërësi me disa ndryshime të vogla sipas kulturave dhe sipërfaqeve të mbjella.

Gjatë kësaj kohe, ne si Drejtori e Bujqësisë, vazhdimisht kemi monitoruar procesin e mbjelljeve pranverore dhe kemi këshilluar fermerët t'i përmbahen masave agroteknike.

Këtë vit aplikimi i fermerëve për subvencione që mbështeten nga Ministria e Bujqësisë ka filluar nga data 28.02.2023 deri më datën 04.04.2023. Gjithsej kanë aplikuar 1098 fermerë për sipërfaqe të kulturave lavërtare, pemëtare, perimore dhe blegtori.

Me fillimin e aplikimit të subvencioneve, Drejtoria e Bujqësisë paraprakisht i ka njoftuar fermerët për afatin dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim dhe gjatë kësaj periudhe procesi ka shkuar mirë, interesimi i fermerëve ka qenë i madh.

Duke pasur parasysh afatin shumë të shkurtër për aplikim, ne kemi punuar edhe jashtë orarit të punës në mënyrë që mos të mbetet asnjë fermer pa aplikuar.

Para fillimit të korrje-shirjeve është formuar komisioni në nivel komunal për përcjelljen e kësaj fushate. Ky komision nga fillimi deri në përfundim ka monitoruar fazën e korrje-shirjeve, inspektimin e autokombajnave për gjendjen teknike të tyre dhe vazhdimisht i kemi këshilluar fermerët që të mos bëjnë djegien e hamulloreve duke pasur parasysh se janë të dëmshme për tokën bujqësore dhe ambientin.

Rendimenti i grurit këtë vit ka qenë mesatar duke marrë parasysh kushtet jo të favorshme klimatike si dhe paraqitjen e sëmundjeve të ndryshme .

Aplikimi i fermerëve për subvencionimin e qumështit dhe viçave për majmëri nga Ministria e Bujqësisë për gjashtëmuorin e parë të vitit 2023 ka filluar prej datës 10.07.2023 deri më 18.08.2023.

Më datë 15.08.2023 deri më 15.09.2023 është hapur aplikimi për dorëzimin e faturave të plehut dhe dëshmitë për sasinë e grurit të dorëzuar nga pikat grumbulluese, të cilët më pastaj ne i kemi dërguar në MBPZHR për subvencionim. Për këtë subvencion kanë aplikuar 833 fermerë.

Nga Drejtoria e Bujqësisë këtë vit janë realizuar këto projekte :

- Projekti i serrave në sipërfaqe 32 m² - përfitues 210 fermerë,
- Shkrirëse të dyllit – përfitues 15 fermerë,
- Projekti i frezave – përfitues 20 fermerë,
- Projekti i mbjellëseve të grurit – përfitues 10 fermerë,
- Projekti i mbjellëseve të misrit – përfitues 10 fermerë,
- Shtrimi i disa rrugëve fushore në Zllakuqan e Krushevë të Madhe,
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Grabanicë,
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Krushevë të Madhe (në ndërtim e sipër),
- Ndërsa me kërkesë të komunës nga MBPZHR Prishtinë në fshatin Budisalc në ndërtim e sipër është kanali ujitjes.

Projektet dhe subvencionet kanë ndikuar në zhvillimin e bujqësisë, rritjen e të ardhurave për ekonomi familjare.

Përpos punëve më palë në zyrë, vazhdimisht ne kemi vizituar fermerët: lavëtarë, bletarë, pemëtarë, blegtorë, të cilët i kemi mbështetur në dhënien e këshillave në këto fusha, orientimin e tyre për një bujqësi të qëndrueshme, po ashtu janë shpërndarë edhe broshura me tema të caktuara në lëmin e bujqësisë.

Për të qenë sa më të suksesshëm dhe për t'u kryer në afat optimal mbjelljet vjeshtore, ne vazhdimisht kemi këshilluar fermerët që të bëjnë përgatitjen me kohë të sipërfaqeve tokësore, të përdorin farërat cilësore të certifikuara dhe plehrat minerale.

Para fillimit të mbjelljeve vjeshtore, ne si Drejtori e Bujqësisë kemi hartuar planin për mbjelljet vjeshtore të cilin po e paraqesim në formë tabelore për vitin 2023-2024.

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara ha	Sipërfaqet e realizuara ha
1.	Grurë	4510	4430
2.	Elb	160	150
3.	Thekër	80	70
4.	Foragjere	540	590
	Gjithsej	5290	5240

Gjatë këtij viti kushtet nuk kanë qenë shumë të favorshme për mbjellje të cilat kanë ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqeve të mbjella me kultura vjeshtore.

Ky vit është karakterizuar me breshër, erërat e forta dhe vërshime dhe në bazë të kërkesave nga ana e fermerëve, ne si komision komunal kemi inspektuar terrenin dhe kemi bërë vlerësimin e dëmit në kulturat bujqësore në bazë të kërkesave të fermerëve.

Ne si Drejtori e Bujqësisë kemi bashkëpunim me Organizatat jo qeveritare, me drejtoritë komunale të Bujqësisë së Komunave tjera.

Në kuadër të Festivalit "I Këndojmë Lirisë", kemi organizuar Panairin e produkteve bujqësore në të cilin fermerët e Klinës dhe të Komunave tjera kanë ekspozuar prodhimet e tyre për tri ditë radhazi.

Sektori i Pylltarisë, gjatë vitit 2023 ka zhvilluar aktivitetet, si në vijim :

Në vazhdimësi ka monitoruar gjendjen e pyjeve në të gjitha rajonet ekonomike pyjore që janë në pronësi shoqërore dhe mbrohen si kompetencë e deleguar nga Komuna e Klinës.

Ka filluar me regjistrimin dëmit pyjor të shkaktuar nga dëmtuesit e pyllit gjatë vitit 2023 dhe i njëjti ka përfunduar. Ka konstatuar se dëmi i arsyetuar me fletëparaqitje në pronën shoqërore është 15.38 m³.

Ka ushtruar dhjetë (10) fletëparaqitje në Gjykatën Themelore Pejë–Dega Klinë, divizionin për kundërvajtje. Kemi pranuar gjithsej 3 aktgjykime nga gjykata Klinë.

Ka përgatitur dhe dorëzuar 10 fletëparaqitje në Gjykatën Themelore Pejë – Dega Klinë .

Ka shqyrtuar njëmbëdhjetë (5) kërkesa të parashtruara nga qytetarët për damkimin e masës drunore në pyjet private. Pas shqyrtimit ka lëshuar katër (5) leje për prerje në pyjet private dhe pesë (5) fletë përcjellje për transportimin e masës drusore të shitura përmes ankandit publik.

Në baza mujore ka përgatitur dhe dërguar raportet mujore, lidhur me aktivitetet e ndërmarra në pyll, në drejtorin koordinuese të APK-se në Pejë;

Ka përgatitur raportet dhe planet mujore të punës, ato vjetore, si dhe planin për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

Ka kryer edhe aktivitete të tjera, sipas urdhrit të drejtorit të Drejtorisë.



**5. DREJTORIA PËR PUNË
INSPEKTUESE**

Drejtor: Faruk Smajli

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Duke u udhëhequr nga parimet themelore të ligjshmërisë, mbrojtjes së të drejtave të qytetarit dhe interesave publike të tij, efikasitetit, dëgjimit të palëve në procedurë, vlerësimit të lirë të dëshmive, vendosje, plotfuqishmërisë së aktvendimeve, drejtorja për Punë Inspektuese e Komunës së Klinës ka përmbushur planin e saj të punës në pikat më kyçe si kontrollin inspektues të zbatimit të ligjshmërisë nga lëmi i shërbimeve publike, ndërtimit, bujqësisë dhe ambientit, tregut, dhe atij të trafikut, - legalizimit të ushtrimit të aktivitetit biznesore të subjekteve ekonomike dhe joekonomike etj.

Me qëllim të ndërtimit të strategjisë afatgjate në jetësimin e sundimit të Ligjit dhe luftimin e Informalitetit -veprimeve kundërligjore të subjekteve që iu nënshtrohen kontrollit inspektues, Organet e Drejtorisë për Punë Inspektuese në periudhën raportuese kanë ndërmarr një serë aktivitetesh dhe veprimesh kordinuese në bashkëveprim edhe me Policinë e Kosovës në: kontrollin e shfrytëzimit të paligjshëm të zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, kontrollin e bizneseve, mbikëqyrjes së rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK-së, KEDS-it dëmtimeve eventuale të rrugëve, trotuareve, hapësirave publike, respektimit të orarit të punës së bizneseve hoteliere sidomos gjatë punës në orët e vonshme të natës, mbarëvajtjes së tregjeve javore, mbikëqyrjen e transportit publik, mbikëqyrjen e pastrimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit, kontrollin e artikujve ushqimor dhe të konsumit ditor nga aspekti i rregullsisë shëndetësore dhe afatshmërisë të përdorimit të tyre, kurse ndërlidhur me këtë nga ana e drejtorisë janë nxjerr një numër i konsideruar i akteve-urdhëresave ekzekutuese për eliminimin e lëshimeve të konstatuara. Këtu duhet shtuar se organizimi i punëve dhe detyrave të punës nga ana e eprorit të organit dhe inspektorëve, pos punëve të ushtruara në orarin e rregullt të punës, është bërë edhe gjatë ditëve të vikendit, festave fetare dhe shtetërore dhe me caktimin e kujdestarive si dhe punës në grupe.

Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë nga sfera për Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat si dhe në emër të taksës për vlerësimin e kushteve minimale higjeno-teknike dhe në shqiptimin e gjobave për shkeljet e shkaktuara ligjore është inkasuar shuma prej 12,422,73 € dhe në emër të taksës për vlerësimin e kushteve minimale higjeno-teknike të hapësirave punuese-lokaleve në të cilat ushtrohet aktivitetit ekonomik janë inkasuar 8,039,60 €.

Në total të hyrat për vitin 2023 janë 20,462,33 €.

Nga personat fizik dhe ata juridik në nivel të drejtorisë janë proceduar 285 kërkesa të ndryshme nga të cilat 275 janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës së paraparë ligjore. 8 janë refuzuara si të pa bazuara – 2 janë anuluar.

Më qëllim të informimit të ndërsjellë në relacionin: Organet e Inspektoratit dhe Drejtoria në raport me drejtoritë tjera dhe Kryetarin e Komunës si dhe në vijën vertikale në raport me Qeverinë dhe Ministrinë gjegjëse, janë hartuar informata, raporte, memorandume dhe relacione tjera zyrtare në kërkesë të tyre dhe ato sipas detyrës zyrtare.

Duke perceptuar dhe shqyrtuar aspektet dhe veprimet e sipërshënuara, pashmangshëm rrjedh konstatimi i paraqitjes edhe të vështirësive dhe pengesave tjera që shfaqen përgjatë ushtrimit të kontrollit inspektues sidomos në numrin jo të mjaftueshëm të inspektorëve krahasuar më numrin e banorëve në komunën tonë.

Në vijim paraqitet në vija të shkurtra puna veç e veç e secilit organ të inspektoratit pa pretenduar që të shkoqiten punët dhe aktivitetet e tyre rutinore dhe në detaje e që janë të përcaktuara në fushëveprimin dhe kompetencat e tyre ligjore.

INSPKEKTIMET NGA LËMIA PUBLIKE

Në këtë lëmi në periudhën raportuese janë ushtruar 327 mbikëqyrje inspektuese e që ka rezultuar me 164 procesverbale të përpiluara në vend. Në objektin e kontrollit ka qenë rrjeti i kanalizimit, ujësjellësit, ai elektrik, i telekomunikacionit, hapësirat urbane publike, organizimi i punëve në pastrimin e mbeturinave, veprimet e koordinuara me inspektorët tjerë në aksione të përbashkëta, inspektimi i tarracave në hapësirat publike, dalja në vend dhe shqyrtimi-trajtimi i kërkesave të ndryshme të personave fizik dhe juridik të natyrës përkatëse, në stinën e dimrit organizimi dhe pjesëmarrja në pastrimin dhe lirimimin e rrugëve nga reshjet dhe punët tjera me prioritet nga fushëveprimi i tij.

Në procedurën e mbikëqyrjes së hapësirave publike janë nxjerr aktvendime për lejimin e bartjes së materialeve ndërtimore, aktvendim për transport (Kamion) për bartjen e furrës së bukës, Aktvendim për bartje të materialit të ngurtë me mjete transportuese (Kamion), Aktvendim për transport bartje të pajisjeve bankare etj.

- ❖ Inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqet publike nga dëmtimet, kyçje ilegale, dëmtimin e rrugëve dhe veprimet tjera ilegale;
- ❖ Inspektimin dhe largimin e pengesave tjera (panove, reklamave të ndryshme, terrasave etj.), nga sipërfaqet publike të cilët nuk janë të pajisur me pëlqim nga organet kompetente;
- ❖ Inspektimin dhe largimin e shitësve ambulantë dhe pengesave tjera të mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave,
- ❖ Tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe sipërfaqeve tjera publike, mbikëqyrin hedhjen e mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, mbikëqyrin zbrazjen pa leje të

- materialeve (rërës, dheut, materialit tjetër ndërtimor,
- ❖ Punë të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret ne fuqi, sipas ankesave te qytetarëve;
 - ❖ Gjoha dhe Procesverbale për mos respektim te urdhrin të Inspektorëve,
 - ❖ Angazhimi ne Komisionin për vlerësimin e dëmeve nga Vërshimet.

Janë shqiptuar gjithsej 12 gjoha dhe 7 aktvendime për qarkullim në vlere prej 2,647,73 euro, prej të cilave:

Gjohje për hedhje të Mbeturinave, per thyerjen e rregullave të komunikacionit me mjete transporti, eksploatim i zhavorrit në mënyrë ilegale, ushtrim veprimtarie të tregut në vende të pa lejuara për mos respektim të afatit për aplikim për shfrytëzim të hapësirës publike për mos respektim të afatit të caktuar kohor për kthim në gjendje të mëparshme, për ndërtim pa leje të tarracës, ushtron veprimtari si taxi ilegal.

INSPEKTIMET NGA LËMI I NDËRTIMIT

Në këtë resor duke ushtruar mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore të ndërtimit janë ushtruar 87 kontrole duke përfshire edhe ato monitoruese inspektuese, janë hartuar 63 procesverbale në vend dhe janë mbajtur nën kontroll të gjitha ndërtimet, duke shtuar këtu edhe organizimin e punës në formë kujdestarie, gjatë ditëve të vikendit dhe atyre të festave të ndryshme. Poashtu, është koordinuar dhe bashkëvepruar më inspektorët tjerë në kuadër të drejtorisë në punët e përbashkëta si ne punët e tregjeve javore inspektimi i terrasave në hapësirat publike me Inspektor te Shërbimeve Publike në kuadër të mbrojtjes dhe ruajtjes së Ambientit etj. Nga ky organ janë shqiptuar 9 gjoha në vlerë prej 8.300.00 €.

INSPEKTIMI NË LËMIN E KOMUNIKACIONIT/TRAFIKUT

Ky organ në vitin 2023 raportues ka ushtruar mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mbarëvajtja e shenjave të trafikut në rrugët rajonale dhe ato lokale, vendosja në kërkesat e palëve etj. Në lidhje me këtë janë hartuar 20 procesverbale si dhe janë evidentuar monitorime nga sfera e qarkullimit të mjeteve të transportit të udhëtarëve si brenda lokalitetit të Klinës ashtu edhe jashtë saj përkatësisht të qendrave të lokalitetit në territorin e Komunës së Klinës. **Është asistuar në vendosjen dhe shejzimin e shenjave vertikale dhe horizontale në qytet dhe në fshatrat e Komunës se Klinës.**

Ku edhe janë bërë procesverbale dhe fotografi për punët në të cilat janë kryer si:

- ❖ Vendosja e vendkalimeve të këmbësoreve prej 650 m²,

- ❖ Janë vendosur 7 vendkalime të këmbësoreve me ndriçim Led në lokacione të ndryshme në qytet,
- ❖ Është bërë vendosje e afër **130 shenjave të komunikacionit** në tërë territorin e komunës së Klinës, si shenja të rrezikut, lajmërimit , urdhrave te prera etj.
- ❖ Furnizimi dhe realizimi i vijës ndarëse të shiritave të qarkullimit afër **2000 metra** shirit ndarës
 - ❖ Furnizimi dhe vendosja e pasqyrës së trafikut të formës rrethore ose drejtkëndëshe

Po ashtu është bashkëvepruar me organet tjera inspektuese ne aksione të përbashkëta të planifikuar nga Drejtoria.

INSPEKTIMI NGA LËMI I BUOËSISË DHE AMBIENTIT

Gjatë periudhës raportuese për vitin **2023** nga lëmi i inspeksionit të bujqësisë dhe ambientit janë ushtruar aktivitete si:

- Inspektime të ekspluatuesit e resurseve natyrore si rërës, gurit, dhe zhavorrit,
- Verifikimin e bartjeve te zhavorrit me mjete transportuese se a janë të pajisur me dokumentet e nevojshme apo bëjnë bartje ilegale të zhavorrit,
- Inspektime për hedhje të mbeturinave në hapësira publike,
- Inspektime për djegie të mbeturinave dhe ndotje të ambientit,
- Kontrolle për kualitetin e prodhimeve bujqësore ,
- Kontrollimin e barnatoreve bujqësore se a janë të pajisur me Aktvendime për ushtrimin e veprimtarisë ,

Nga këto aktivitetet janë bërë **62** kontrole inspektuese prej tyre janë bërë **62** procesverbale mbi konstatimin e gjendjes, si dhe **14** gjoba të shqiptuara , **10** gjoba për eksplantim i zhavorrit dhe bartje e zhavorrit në mënyre ilegale, **7** gjoba për hedhje të mbeturinave në hapësira publike, **9** djegie e mbeturinave dhe ndotje të ambientit dhe **3** raste për inicim procedure për kundërvajtje ne Gjykatën Themelore dega Kline

Në total realizimi i te hyrave është 985.00 €.

INSPEKTIMI NË LËMIN E TREGUT

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe mbi bazën e obligimit ligjor për përpilimin dhe skicimin e shënimeve dhe të dhënave për punën dhe aktivitetin e ushtruar dhe punëve të kryera gjatë vitit **2023**, më poshtë do të listohen punët dhe

aktivitetet punuese të organit të Inspektoratit të Tregut sipas strukturës dhe tipeve të kontrollit të ushtruar ndaj subjekteve që i u janë nënshtruar mbikëqyrjes inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore pozitive të Ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, atë për Tregtinë e Brendshme, të Mbrojtës së Konsumatorëve , Njësive matëse.

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, kualiteti i produkteve industriale dhe ushqimore, cilësia e shërbimeve, verifikimi i regjistrimit (pajisje me Çertifikata për Regjistrim të Biznesit të), të gjitha subjekteve afariste tregtare dhe shërbyese, objekteve dhe subjekteve tjera, pajisëshmëria me Leje të Punës.

Procesverbale të hartuara mbi faktimin e gjendjes e që i referohen të njëjtit aktivitet për përcaktimin e veprimeve dhe procedimi i mëtejme administrativo-procedural-97.

Puna në Komisionin Inspektues në përcaktimin e kushteve minimale teknike, sanitare-higjienike, ku janë pajisur 69 lokale me Aktvendime dhe inkasuar 8.039.60 €, nga bizneset ku janë plotësuar urdhërpagesat për kompensim të pagesave në emër të taksës.

Në koordinim me Zyrën për biznese është punuar në zgjidhjen e kërkesave për lejimin e zgjatjes së orarit të punës së subjekteve afariste nga lëmia hoteliere dhe kafiteri që është në konformitet me Rregulloren përkatëse komunale, shënohen raste 13.

Në bashkëveprim me Inspektorin sanitar dhe të tjerë është larguar nga qarkullimi mall dhe produkte ushqimore me afat të skaduar për përdorim të prishura- pa deklaracion për shitje ku është inkasuar shuma prej 90 € në emër të taksës për punën komisionarë konform Rregullores për Taksat, Ngarkesat dhe Tarifat, kurse vlera e mallit të asgjësuar 54,221€.

Gjoha të shqiptuara ndaj subjekteve dhe individëve për shkelje ligjore (për përcaktuara me dispozita ligjore), gjatë ushtrimit të aktivitetit afarist apo të ngjashme për 3 raste që kap shumën totale prej 400.00 €. **Në total realizimi i te hyrave është 8,529,60 euro**

Në pasqyrimin e punëve dhe aktiviteteve punuese për vitin raportues nuk është përfshirë puna qoftë vetanake, qoftë në bashkëveprim me Inspektoret e Tregut pranë MTI-së sipas Planit të Veprimit të Inspektoratit të Tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës për çfarë sipas një vije të veçantë ka qenë e nevojshme korespondimi dhe raportimi për të njëjtit.

PROPOZIMI I MASAVE:

Duke konkluduar mbi konstatimet e sipërhënuara dhe efektet e arritura nga periudha raportuese, paraqitet domosdoshmëria në ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në shtimin e numrit të Inspektorëve sipas standardeve ligjore në përpjesëtim me numrin e rezidentëve/banorëve/në Komunë.



**6. DREJTORIA E URBANIZMIT
DHE MBROJTJES
SË MJEDISIT**

Drejtore: Enver K. Berisha

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Klinës, gjithë fushë veprimtarin e vet e ushtron në bazë të dispozitave Ligjore, rregulloreve që janë në fuqi, planeve dhe është ekuikutuese e drejtpërdrejte e Vendimeve të Asamblesë Komunale.

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit veprojnë:

Shërbimi i Ndërtimit dhe Banimit	Në kuadër të kësaj drejtorie ushtrohen këto veprimtari:	- Punët dhe aktivitetet rreth ndërtimit dhe banimit
Zyra për Mbrojtje të Mjedisit		- Legalizimi
Planifikimi Urban		- Punët dhe aktivitetet rreth Urbanizmit – Planifikimit
Zyra për Projekte		- Leje mjedisore komunale
		- Mirëmbajtja e sistemit të adresave
		- Hartim të paramasave dhe paralogarive, përgatitje të projekt propozimeve, raporte
		teknike, procesverbale, shkresa etj.
		- Menaxhim dhe mbikëqyrje të ecursisë së punimeve për të gjitha projektet, pranimet teknike për projektet që janë në kuadër të kësaj drejtorie dhe drejtorive tjera si dhe bënë inspektime në terren sipas kërkesave të palëve.

Gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023 në këtë Drejtori janë pranuar **1078** lëndë, si: kërkesa për leje ndërtimi, kërkesa për kushte ndërtimi, kërkesa për leje mjedisore komunale, kërkesa për legalizim, fatura dhe kërkesa të natyrave të ndryshme.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ka vendosur si më poshtë:

775 lëndë të miratuara prej të cilave janë:

Kushte të ndërtimit	Leje ndërtimi	Leje mjedisore	Leje legalizimi	Leje rrënimi
95	95	18	59	2

506 lëndë janë: referenca, vërtetime, pëlqime, procesverbale, vendime, fatura, njoftime, shkresa dhe kërkesa të ndryshme.

Lëndë janë në proces	Lëndë të refuzuara	Lëndë të pezulluara	Lëndë të hedhura poshtë	Lëndë të anuluar	Lëndë të pranuar	Lëndë të ceduar
18	174	56	6	31	9	9

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit këtë vit ka krijuar të hyra buxhetore në vlerë prej **303,152.80€** nga lejet e ndërtimit, kushtet e ndërtimit, lejet mjedisore komunale, legalizimi pëlqimet etj.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka menaxhuar, mbikëqyrur dhe realizuar projektet si më poshtë:

N R	Nr. i kontratës	Emërtimi i kontratës	Vlera e kontratës 2023-24	Rrugë të asfaltuara (m)	Kanal izim fekal (m)	Trotuar	Ndriçim elektrik (m)	Shtrat i lumit (m)	Përfundimi i projektit
1	005-2023	Ndërtimi i stacionit të autobusëve, faza II	84,900.00						pranim teknik
2	013-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale: Shtupel, Kërrnicë,	129,999.00	3,500	800				pranim teknik

		Binxhë, Grabc							
3	024-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Caravik-Çabiq	69,875.00	1,500	300				pranim teknik
4	028-2023	Ndërtim i rrugëve dhe inf. nëntokësore Gjurgjevik i madh	67,795.00	1,300					pranim teknik
5	030-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale dhe inf. në Qeskovë	22,820.88	50					pranim teknik
6	87-2023	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës Gjurgjevik i Madh, faza II	16,967.50	300					pranim teknik
7	96-2023	Ndërtimi i urës dhe rrugës në fshatin Budisalc-Rudicë	60,178.20	1,100					vazhdon
8	120-23	Asfaltimi i rrugëve Gremnik, faza e II	44,900.00						vazhdon
9	97-2023	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës	54,890.00	760	450				pranim teknik

		Gllarevë, Rixhevë							
10	045-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Ujmirë, Shtaricë Siqevë	54,000.00	350	1,043				pranim teknik
11	056-2023	Ndërtim i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Poterq, Dugajevë	109,560.00	2,100	822				pranim teknik
12	079-2023	Asfaltimi i rrugëve Krushevë e Vogël	64,485.00	381					vazhdon
13	081-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Ujmirë, Siqevë Shtaric, faza III	34,688.50	150					vazhdon
14	134-23	Ndërtimi i liqenit akumulues për uji të pijes	149,450.00						vazhdon
15	139-23	Ndërtimi i ujësjellësit në komunën e Klinës	40,982.00						vazhdon
16	112-23	Asfaltimi i rrugëve dhe	198,500.00	1,100					vazhdon

		infrastrukturës nëntokësore Dresnik- Dollc, faza e III							
17	88-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Gjurgjevik i Vogël	19,665.05		1,060				pranim teknik
18	039-2023	Asfaltim i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Sferkë- Volljakë- Qupevë	149,000.00	2,100	100				pranim teknik
19	042-2023	Ndërtim i rrugëve dhe inf. nëntokësore Videjë, Paskalicë- Krushevë e Madhe	100,000.00	1,500					vazhdon
20	86-22	Asfaltimi i rrugëve dhe infr. nëntokësore në Klinë 2022	234,000.00	600	700	920			pranim teknik
21	034-2023	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës	99,792.50		4,500				pranim teknik

		nëntokësore Dresnik- Dolc, faza e I							
22	113-2023	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Dresnik- Dolc, faza e II	43,999.95		90.00				vazhdon
23	068-2023	Asfaltimi i rrugës "Afrim Haliti" Jashanicë	135,000.00	2,500	493				pranim teknik
24		Asfaltimi i rrugës "Afrim Haliti" Jashanicë- aneks	11,813.94	74.00	145				pranim teknik
25		Asfaltimi i rrugës "Afrim Haliti" Jashanicë, faza 2	20,000.00	235					pranim teknik
26	85-2023	Shtrimi i rrugëve fushore	50,500.00				500		pranim teknik
27	118-23	Fasadimi i objekteve të vjetra, fasada e V	25,999.00						vazhdon
28	117-23	Ndërtimi i shtigjeve të	34,723.50	352					pranim teknik

		ecjes dhe infr. nëntokësore në drejtim të grykës së Jarinës.							
29	57-2023	Ndërtimi i rrugëve me inf. nëntokësore në Grabanicë- Bokshiq- Dollovë	50867.5		2,006			1,000	pranim teknik
30	91-2023	Ndërtim i trotuarit me ndriçim në fshatin Shtupel dhe Budisalc	97,699.99	450		1,000	1000		vazhdon
31	038-2023	Asfaltim i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Përçevë	44,975.16		300	1,200			pranim tekinik
32	073-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Caravik- çabiq, faza III	61,000.00	1,150					vazhdon
33	083-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Resnik- Jelloc- Jashanicë	229,999.00	2,000	1,000				vazhdon
34	106-2023	Rregullimi i	59,962.00						pranim teknik

		oborreve, varr ezave dhe ndërtesave fetare							
35	074-2023	Fasadimi i objekteve të vjetra në Klinë	49,444.00						pranim teknik
36	076-2023	Rregullimi i parqeve në Klinë	20,000.00						
37	40-2023	PZHK	27,376.00						vazhdon
38	103-2023	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore në Klinë (SHESHI)	289,894.80	270		270	270		vazhdon
39	63-2022	SHTEGU I BIÇIKLETA VE	474,970.00			2,380	2,380		vazhdon
40	40-2021	Asfaltimi i rrugëve infrastrukturës nëntokësore Dresnik 2021 - 2022 -2023	162,640.80	4,800	4,800.	1,814	2,045		pranim teknik
41	031-2023	Asfaltimi i rrugëve lokale Zajm- Deiq	264,000.00	1,000					vazhdon
42	063-2023	Rinovimi i rrugëve me asfalt në komunën e Klinës	296,000.00	4,000					pranim teknik

43	070-2023	Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës Zllakuqan - Pataqan-Berkovë	78,040.59		150				vazhdon
44	072-2023	Rregullimi i shtratit të lumit Klina	746,046.00				500	500	vazhdon
45	145-2023	Rregullimi i shtratit të lumit Klina-muri mbrojtës	13,000.00						pranim teknik
46	110-2023	Ndërtimi i fundërruesit për sistemin e filtrimit të ujit të pijes në Klinë	849,921.63						vazhdon
47	138-2023	Punë shtesë Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës Zllakuqan-Pataqan-Berkovë	4,169.00						pranim teknik
48	109-2023	Hartimi i projekteve zbatuese	50,000.00						vazhdon
49	061-2023	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në Rudicë	29,997.00				4,000.		pranim teknik
50	077-2023	Blerja e E-Kioskut	24,985.00						pranim teknik
51	082-2023	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në Klinë	97,980.00				14,000		pranim teknik
			6,151,453.4	33,622	18,759	7,584	24,195	2,000	

Pra, gjatë periudhës një vjeçare janë punuar :

33,622.00 m rrugë të asfaltuara,

18,759.00 m kanalizim fekal,

7854.00 m trotuar,

24,195.00m ndriçim publik,

2000.00m rregullim i shtratit të lumenjve.

Buxheti për periudhën janar-dhjetor 2023 ishte i planifikuar me shumën prej 4,231,463.06 euro.

Prej tyre janë realizuar 3,897,202.91 euro në përqindje realizimi është 92.10% (në këtë përqindje nuk përfshihen mjetet e performancës nga MAPL).

Gjatë kësaj periudhe punëtorët e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kanë marr pjesë në komisione për hapje dhe vlerësime të ofertave për projekte të ndryshme të Drejtorisë për Urbanizëm dhe drejtorive të tjera si dhe komisione të ndryshme.

Janë mbajtur takime të ndryshme me donatorë si dhe dikasteret e linjës me qëllim të harmonizimit të punëve si dhe përfitimit të projekteve të ndryshme.

Janë mbajtur takime të rregullta me kompanitë si "Hidrodrini", KRM "Ambienti", KEDS, PTK, që të na ofrojnë të gjitha projektet që kanë planifikuar për Komunën e Klinës.

Gjatë kësaj periudhe është bërë plani i punës dhe plani i prokurimit për vitin 2024, raporte mujore rreth punës së drejtorisë, janë bërë vlerësimet dhe sistemimet e dosjeve të këtij viti si dhe punë tjera që kanë të bëjnë me planifikimin, detyrat dhe aktivitetet e drejtorisë.

Është bërë shënimi i datave mjedisore, siç janë:

Dita e tokës -22 prilli,

Ta pastrojmë Kosovën- 24 maji,

Dita e Mjedisit -5 qershor.

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje ka bërë edhe punë tjera si inspektime në terren sipas kërkesave të palëve, paramasa dhe paralogari për rrugë, rrënim të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, detyra projektuese, kërkesa, projekt-propozime, raporte, mbikëqyrje të projekteve, pranime teknike etj.



**7. DREJTORIA E
SHËNDETËSISË DHE
MIRËQENIES SOCIALE**

Drejtor: Agron Bacaj

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Fushëveprimtaria:

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Shëndetësi, Statutin e Komunës së Klinës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet, drejtorja ka këtë fushëveprim:

- ✓ Vlerëson nevojat lokale shëndetësore;
- ✓ Harton buxhetin në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton kujdesin parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare;
- ✓ Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga MSh;
- ✓ Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- ✓ Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- ✓ Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel të komunës;
- ✓ Mbledhë dhe analizon informatat në fushën shëndetësore në nivel lokal;
- ✓ Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve si dhe Qendrës për Punë Sociale;
- ✓ Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën shëndetësore;
- ✓ Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- ✓ Harton propozimet për lirimet nga pagesa për shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;
- ✓ Ndërmerr veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve shëndetësorë nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton kujdesin parësor shëndetësor në sektorin publik, nëpërmjet shërbimeve të mjekësisë familjare, dhe përcjell gjendjen shëndetësore të qytetarëve në territorin e komunës;
- ✓ Harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuar

- në nivel lokal duke u dhënë prioritet masave parandaluese, dhe në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë dhe pozitës ekonomiko - sociale të qytetarëve dhe kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor; kushteve teknologjike - mjekësore, distancës dhe konfiguracionit gjeografik, si dhe strukturës dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor;
- ✓ Ndërmerr masa parandaluese për zbulimin dhe diagnostikimin e hershëm, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
 - ✓ Organizon dhe zbaton procesin e imunizimit në pajtim me legjislacionin në fuqi, si një nga masat themelore të kujdesit ndaj shëndetit publik;
 - ✓ Kujdeset për përparimin e shëndetit të fëmijëve, të rinjve dhe grupeve tjera;
 - ✓ Promovon shëndetin oral dhe kujdesin themelor stomatologjik si dhe shëndetin mendor, në pajtim me metodat e avancuara;
 - ✓ Kujdeset për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik të qytetarëve të komunës, nëpërmjet aktiviteteve parandaluese (por duke mos u kufizuar vetëm në këto), si: promovimit të mënyrës së shëndoshë të jetesës, edukimit shëndetësor, ndërmarrjes së masave të përgjithshme kundër epidemike dhe preventive, si: dezinfektimi hapësinor, deratizimi dhe dezinfektimi, kontrollimi i mjedisit, kontrollimi i shkaktarëve, si dhe parandalimi i sëmundjeve, çrregullimeve, lëndimeve dhe gjendjeve me rëndësi sociale mjekësore;
 - ✓ Zhvillon programe për aftësimin profesional të punëtorëve shëndetësorë nëpërmjet "Zhvillimit të vazhdueshëm profesional" (ZHVP), me qëllim të ngritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor;
 - ✓ Bashkëpunon me kujdesin dytësor dhe tretësor shëndetësor, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - ✓ Vlerëson nevojat lokale për shërbime sociale;
 - ✓ Harton buxhetin në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
 - ✓ Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga niveli qendror;
 - ✓ Vendos dhe mbledh bashkëpagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;
 - ✓ Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e shërbimeve sociale;
 - ✓ Ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës, brenda territorit

- të komunës;
- ✓ Kujdeset për të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda territorit të komunës;
 - ✓ Bashkëpunon me ministrinë përkatëse për vendosjen dhe zbatimin e politikave sociale, për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha grupet tjera në nivelin lokal, përmes QPS – së;
 - ✓ Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta; Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
 - ✓ Mbledhë dhe analizon informatat në fushën sociale në nivel lokal;
 - ✓ Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën sociale;
 - ✓ Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
 - ✓ Përgatitë planet vjetore për zhvillimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajtjen e shënimeve statistikore;
 - ✓ Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministrinë e linjës;

QKMF / QMF / AMF – Raport i punës

Objektivi kryesor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, përgjatë vitit 2023, ka qenë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë rritja e numrit të shërbimeve mjekësore të ofruara në QKMF, është përmirësuar furnizimi me medikamente për pacientët, janë përmirësuar shërbimet e patronazhës, kujdesit paliativ, etj.

Furnizimet mjekësore (barna dhe pajisje mjekësore), janë bërë me kohë dhe në sasi të mjaftueshme falë investimeve nga Komuna e Klinës si dhe nga Lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë. Qytetarët tanë kanë marrë shërbime cilësore në QKMF dhe janë furnizuar në masë të madhe me barna.

Rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësisë në Diagnostikë - Edhe në shërbimin e diagnostikës në QKMF janë kryer numër i madh i shërbimeve cilësore, analiza laboratorike dhe shërbime të rëntgenit, me aparatura moderne dhe pa kosto për shumicën e qytetarëve. Më shumë se 20,000 qytetarë kanë kryer shërbime diagnostike, analiza laboratorike dhe shërbime të rëntgenit. Gjatë vitit 2023 është bërë furnizimi me pajisje të reja mjekësore në sektorin e diagnostikës dhe stomatologjisë, të cilat do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e shërbimeve të ofruara si

dhe do të rrisin edhe gamen e shërbimeve në diagnostikën e QKMF-së. Vlera e pajisjeve të reja të blera në QKMF nga buxheti i komunës është rreth 85,000 euro. Gjithashtu, kemi pranuar donacione në pajisje të reja nga KFOR-i si dhe Ministria e Shëndetësisë.

Gjatë vitit 2023 nuk kanë munguar edhe investimet kapitale në QKMF, duke përmirësuar dukshëm kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve profesionale për qytetarët e komunës sonë. Janë krijuar hapësira të reja dhe është bërë rinovimi i hapësirave ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve mjekësore, ordinancave specialistike dhe barnatores së QKMF-së.

Vlera e investimeve kapitale gjatë vitit 2023 ka qenë rreth 200.000 euro, prej tyre nga buxheti i komunës janë shpenzuar rreth 45,000 euro, rreth 140,000 janë shpenzuar nga zyra e BE-së në kuadër të projektit "EU For All", projekt ky që ka për qëllim përmirësimin e kushteve për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në objektin e QKMF në Klinë.

Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore për përmirësimin e shërbimeve mjekësore ka qenë prioritet edhe përgjatë vitit 2023. Është bërë trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore përmes bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera relevante si dhe janë kryer procedurat e rekrutimeve për stafin mjekësor dhe teknikëve të infermierisë. Ka vazhduar bashkëpunimi me donatorët ekzistues dhe janë zhvilluar takimet e reja me donatorët potencial ku janë prezantuar objektivat tona parësore dhe projektet e planifikuara.

Vëmendje e madhe i është kushtuar programit për kujdesin mjekësor për të moshuarit, kujdesit paliativ dhe pacientëve terminal si dhe kujdesit mjekësor për komunitetet pakicë.

Është rritur angazhimi në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët 0-3 vjeç si dhe gratë shtatzëna dhe lehonat, duke pasur mbështetje të vazhdueshme edhe nga programi i UNICEF-it. Është bërë ofrimi i shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientët që nuk kanë mundur të kryejnë shërbimet mjekësore në QKMF dhe AMF.


**Vizita
mjeksore**

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gushte	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Mjekësia Familiare	6441	5072	6855	5150	5272	3842	4874	7858	5533	6044	5379	4214	66534
Pediatria	515	462	754	423	769	866	617	644	587	761	719	887	8004
Gjinekologjia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Stomatologjia	197	172	185	111	134	105	0	104	123	156	95	1401	2783
Specialistika	1392	2122	2344	1583	1519	1648	1043	1912	1575	1606	1747	1768	20259
Totali	8545	7828	10138	7267	7694	6461	6534	10518	7818	8567	7940	8270	97580

Totali

Mjekësia Familjare	66534
Pediatria	8004
Gjinekologjia	0
Stomatologjia	2783
Specialistika	20259
Totali	97580

Shpërndarja e vizitave mjekësore



■ Mjekësia Familiare
 ■ Pediatria
 ■ Gjinekologjia
 ■ Stomatologjia
 ■ Specialistika

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Trendi												
Mujor	8545	7828	10138	7267	7694	6461	6534	10518	7818	8567	7940	8270



Shërbimet

Shëndetësore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Barnatorja	149	854	644	535	565	557	645	690	619	578	650	693
Echo	2	0	32	6	5	77	0	0	0	0	6	0
Ekg	138	54	65	117	235	115	90	164	122	54	63	46
Injeksione	3844	2716	3573	2692	2764	2786	3036	2925	2583	2742	2097	2113
Infuzione	1974	1305	1919	1614	1488	1272	1027	2554	1846	1360	1116	1207
Inhalime	267	98	102	18	74	130	73	120	83	79	54	44
Laboratori	1462	1535	1670	1187	1499	1339	1178	1281	1391	1406	1319	1318
Lidhje	517	563	466	557	654	550	661	1553	772	889	741	465
Qepje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Rentgeni	585	497	486	348	485	461	165	504	497	693	507	0
Vaksinimi	144	137	1215	80	163	149	148	141	188	173	159	142
Terreni	496	298	660	476	536	574	345	463	481	631	588	351
Totali	9578	8057	10832	7630	8468	8010	7368	10395	8582	8605	7300	6379


Barnatorja	7179
Echo	128
Ekg	1263
Injeksione	33871
Infuzione	18682
Inhalime	1142
Laboratori	16585
Lidhje	8388
Qepje	0
Rentgeni	5228
Vaksinimi	2839
Terreni	5899

Totali 12 mujor i shërbimeve




	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Trendi mujor i shërbimeve	9578	8057	10832	7630	8468	8010	7368	10395	8582	8605	7300	6379

Trendi Mujor i shërbimeve



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	12 Mujori
Trendi mujor i shërbimeve	10397	8166	9919	7378	7579	9077	9442	7086	8532	9695	7300	6379	94571
Trendi mujor i vizitave	9177	7758	8980	5979	7266	7743	7428	7494	7503	7595	7940	8270	84863
Totali	19574	15924	18899	13357	14845	16820	16870	14580	16035	17290	15240	14649	179434


Të kombinuara




	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Furnizimi i Barnatores nga M.SH	10%	20%	20%	20%	25%	25%	25%	20%	20%	20%	20%	20%

Insulinë	247	169	174	166	166	171	171	172	231	235	237	237
Insulinë Fëmijë	7	7	7	7	7	7	7	7	6	6	6	6
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Të Aksidentuar	11	6	6	7	18	8	10	15	6	19	1	17
Vdekje	2	1	1	1	1	0	1	0	0	1	0	2
Psikologjike	27	19	19	4	10	5	0	8	6	10	10	8
Vizitat në shtëpi nëna dhe fëmijë	105	113	127	78	116	103	114	98	158	131	117	125

Trendi i
furnizimit



Pacientet me Insulinë



Periudha Janar -Dhjetor 2023

Shërbimet e Patronazhit janë 1475

Vaksina kundër gripit sezonal janë 1498

Në këshillimore paciente janë 1376

Në pulmologji numri i pacientëve me TBC janë 13; prej tyre pozitiv 8 dhe negativ 5 (9M, 4F)

Spektori i Shërbimeve Sociale

Spektori i Shërbimeve Sociale gjatë vitit 2023 ka kryer shërbime të ndryshme në përkrahje të familjeve dhe personave në nevojë sociale, në këto shërbime përfshihen nga këshillimi deri të përkrahja për familjet me probleme sociale, kujdesi dhe mbrojtja e fëmijëve, kujdesi dhe mbrojtja e të moshuarve, si dhe shërbime tjera shtesë administrative (vërtetime, deklarata të ndryshme dhe shkresa tjera).

Bashkëpunimi i Sektorit të Shërbimeve Sociale me Institucione si, Policia e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjykata Themelore në Pejë - Dega Klinë, institucionet shkollore, zyra për ndihmë juridike falas, si dhe me OJQ të ndryshme ka qenë në nivelin më të mirë të mundshëm.

Gjatë vitit 2023, Shërbimi Social ka realizuar vizita në familje të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë në strehim familjar, fëmijë nën kujdestari, ka marr pjesë në intervistimin e të miturve në polici, ka marr pjesë në seanca gjyqësore, si dhe ka realizuar vizita tjera në familje të ndryshme ku është paraqitur nevoja e ofrimit të shërbimeve sociale.

Me poshtë e keni raportin e sektorit të Shërbimeve Sociale në formë tabelore

Nr.	Shërbimet e kryera	Numri i rasteve të reja	Numri i rasteve aktive (ekzistuese)	Vërejtje
1	Kujdestari për fëmijë	4	19	
	Kujdestari për raste të veçanta	2	9	
2	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin	12	0	
3	Adoptime – Periudhë provuese për Adoptim	1	0	
4	Dhunë në familje	25	23	
5	Strehim familjar brenda familjes biologjike/nr fëmijëve	0	8	
6	Strehim në shtëpinë e sigurt në Pejë	8	0	
7	Vendosje të fëmijëve në SOS fshatin e fëmijëve në Prishtinë	0	1	
8	Strehim i personave madhorë në Institutin Special në Shtime dhe Deçan	2	6	
9	Strehim i fëmijëve në shoqatën “Caritas Umbria”, në Leskoc	0	4	
10	Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin	31		
11	Çrregullime familjare	4	2	
12	Përcjellje të kontaktit fëmijë-prind	8	8	
13	Shkurorëzime	14	2	
14	Fëmijë nga prindërit e shkurorëzuar	26		
15	Strehim i të moshuarve në shtëpinë për të moshuar në Gurakoc dhe Skenderaj	1	5	
16	Vërtetime dhe deklarata	387		
17	Kërkesa për mbështetje financiare familjes për fëmijë me nevoja të veçanta	13	75	
18	Pjesëmarrje në seanca gjyqësore dhe polici	39		
19	Kujdestari për përfaqësime në seanca gjyqësore	3		
20	Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për privim të së drejtës prindërore	0		

Sektori i Asistencës Sociale

Në periudhën që po raportojmë, numri i familjeve shfrytëzuese të Ndhmës Sociale në të dy kategoritë është 798.

Gjithashtu, gjatë periudhës që po raportojmë në bashkëpunim me Kuvendin Komunal, Organizata humanitare, bizneset e ndryshme, Organizatat jo Qeveritare etj, i kemi ndihmuar disa familje nevojtare me pako të ndryshme (higjienike, ushqimore, veshmbathje).

Me poshtë e keni raportin e sektorit të Asistencës Sociale në mënyrë tabelore për periudhën raportuese:

Aktivitetet	Kategoria I dhe II
Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë	46
Sa prej tyre janë të aprovuara	35
Sa prej tyre janë të refuzuara	8
Sa janë në shqyrtim	3
Numri i rasteve të ndërprera	28
Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e As. sociale	20
Në shkallë të parë (I)	20
Në shkallë të dytë (II)	20
Numri i ankesave të aprovuara	0
Numri i ankesave të refuzuara	15
Nr. ankesave në shqyrtim	5

Realizimi i të hyrave nga tarifat administrative të Qendrës për Punë Sociale

Bazuar në Rregulloren mbi Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, në Institucionin e QPS-së, tariforen disa nga vërtetimet që i lëshon ky Institucion. Gjatë kësaj periudhe që po raportojmë, kemi arritur që të grumbullojmë një shumë të konsiderueshme të të hollave, të cilat janë derdhur në xhirollogarinë e Komunës së Klinës. Në vazhdim në mënyrë të detajuar i keni të hyrat që janë grumbulluar për periudhën janar – dhjetor 2023:

Muaji	Përshkrimi	Nr. & tarifa adm.	Shuma totale - Euro
Janar - Dhjetor 2023	Vërtetim që nuk i është marr ose kufizuar aftësia për të vepruar (për marrjen e lejes për armëmbajtje)	265 x 20 €	5,300.00 €
Janar - Dhjetor 2023	Vërtetim për lirim / fitim nga shtetësia e Kosovës	117 x 10 €	1,170.00 €
Janar - Dhjetor 2023	Vërtetim që nuk është shfrytëzues i Asistencës Sociale	64 x 2 €	128.00 €
			Totali: 6,578.00€

Sfidat

- Grumbullimi e të hyrave vetanake të mbledhura nga QPS, në një kod të veçantë buxhetor të Qendrës për Punë Sociale/Shërbime Sociale, mjete këto ku do mund të shfrytëzoheshin për pagesat e punëtorëve që angazhohen jashtë orarit të punës/kujdestari, si dhe për nevoja tjera për ndihmë të menjëhershme familjeve në nevojë sociale.
- Rritja e buxhetit të Qendrës për Punë Sociale, tek kategoria e shpenzimeve -mallra dhe shërbime.

Përfundimi

Qendra për Punë Sociale, kujdeset për banorët e Komunës sonë në nevojë për shërbime sociale dhe ndihmë financiare, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, dhe orientime tjera. Shuma e të hollave që shpërndahen përmes këtij Institucioni brenda një viti kalendarik është rreth **1.1 milion Euro**, duke përfshirë këtu familjet përfituese të Asistencës Sociale, familjet që kanë fëmijë me nevoja të veçanta si dhe familjet që kanë në strehim fëmijë pa përkujdesje familjare.

Konsiderojmë se, edhe përkundër disa sfidave, periudhën që po raportojmë e kemi përmbyllur suksesshëm, krejt kjo falë punës së stafit të QPS-së, me punën dhe angazhimin e të cilëve është bërë realizimi i planit dhe detyrave të punës, gjithashtu edhe falë bashkëpunimit të mirë me DSHMS-në, DPSF-në, si dhe me institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare.

Mbesim me shpresë që angazhimi dhe bashkëpunimi në vitin e ardhshëm do rritet, në mënyrë që të arrihet në plotësi realizimi i të gjitha detyrave dhe objektivave për vitin 2024.



**8. DREJTORIA PËR SHËRBIME
PUBLIKE DHE EMER GjENCË**

Drejtore: Qendrim Millaku

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente, gjatë këtij viti është preokupuar në realizimin e plotë të punëve të planifikuara dhe mund të konstatojmë se ka qenë një vit shumë i suksesshëm. Gjatë periudhës vjetore 2023 në sektorin e shërbimeve publike nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej **888 kërkesa**, të cilat kanë të bëjnë kryesisht dëmet e vërshimeve nga muaji i janarit, ku kishin pësuar shumica e qytetarëve të lagjeve të mëdha të Klinës, por edhe fshatrave dhe me riparimin e rrugëve me zhavorr në fshatra dhe disa rrugica nëpër lagje të qytetit, riparim të gropave në rrugët me asfalt, furnizim me ujë dhe riparim të ujësjellësit, riparim dhe kyçje në kanalizim, leje për shfrytëzim të hapësirës publike, kërkesa për ndriçimin publik si dhe kërkesa për ndihmë me artikuj ushqimor dhe materialit ndërtimor për ndërtim apo rinovim të shtëpive. Varësisht nga mundësitë buxhetore u jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Nga ana e drejtorisë janë shqyrtuar këto kërkesa dhe gjendja është si në vijim:

Përshkrimi	Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes 01.01.2023 – 01.01.2024 DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENTE
Pranuar	0
Në Proces	8
Miratuar	785
Refuzuar	47
Hedhur Poshtë	46
Pezulluar	2
Ceduar	0
Anuluar	0
GJITHSEJ	888

Ndërsa sa ju përket projekteve të realizuara dhe në realizim e sipër për këtë vit, shkurtimisht po i theksojmë disa prej rezultateve të arritura për vitin 2023:

- **Sanimi i gropave të rrugëve me asfalt në Resnik, Leskoc etj - puna shtesë.**

Kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve me titull është kontraktuar më 21.03.2023 dhe ka kohëzgjatje 12 muaj, deri më 21.03.2024 me vlerë 204,100.00 €. Paramasa e kontratës përfshin këto pozicione: sanimi i gropave, kapakët e pusetave, muri mbrojtës dhe gypa me dimensione 400 - 600mm. Kontrata përfshin sanimet dhe mirëmbajtjen në qytet dhe fshatrat e komunës së Klinës, ndërsa me punë shtesë me vlerë 19,675.00 € është rritur sasia e sanimit të gropave dhe

kapakëve të pusetave.

- **Trajtimi i qenve endacakë.**

Qentë endacakë janë problem i gjithë Kosovës. Komuna e Klinës është ndër komunat e pakta të Kosovës që kanë lidhur kontratë për trajtimin e qenve endacakë. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente kishe lidhur kontratë me shumën 30,000 € ku në këtë kontratë ne kemi trajtuar, sterilizuar, shëruar, larguar dhe ushqyer qentë endacakë, është bërë kastrimi i tyre dhe janë mbajtur dhe ushqyer e mbikëqyrur deri në shërimin e plotë të tyre, pastaj ata përsëri janë lëshuar në vendin ku janë kapur, atyre ju ka kaluar tërbimi dhe rreziku nga ta, kjo ka rezultuar në një sukses nga ana jonë sepse janë eliminuar shumë rreziqe për qytetarët.

- **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në qytet dhe fshatra.**

Sipas Planit Operativ, territori i Komunës së Klinës është ndarë në tri pjesë. Operatori i përzgjedhur ka siguruar sasinë e mjaftueshme të kripës dhe rërës për akull, ndërsa makineria është në gatishmëri sipas kërkesave dhe kushteve të parapara me kontratë. Kemi inspektuar gatishmërinë në vendet e caktuara, kemi intervenuar në muajin nëntor vetëm për disa ditë.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i kamerave të qytetit.**

Është bërë zgjerimi i rrjetit të kamerave dhe vendosja e tyre në vende të reja, tek shkolla "Ismet Rraci, ku janë zgjatur fibrat optike dhe janë vendosur tri kamera tek shkolla, nga trekëndëshi i sheshit "Mujë Krasniqi" mbi ndërtesën e kuqe deri tek shtylla, tek sheshi "Nënë Tereza", si dhe njëherë është bërë mirëmbajtja e kamerave, dhe kemi vendosur një kamerë tek selia e Zjarrfikësve në Klinë.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik.**

Në vitin 2023 Komuna e Klinës ka mirëmbajtur rrjetin e saj në shumicën e fshatrave të Klinës, si në fshatin Gllarevë, Ujmirë, Budisalc, Deiq, Zabërgjë, Zajm, Dollovë, Volljakë, Sferkë, Pjetërq, Grabanicë, Shtupel dhe fshatra tjera. Investim ka pasur edhe në lagjet e qytetit, si në lagjen "Arbëria", "Dukagjini", lagjen e "Spitalit" dhe qendrën e qytetit me rrugët kryesore. Kontrata mbaron në vitin 2024.

- **Shtrimi i rrugëve fushore.**

Në vitin 2023 ka pasur shumë dëmtime nga vërshimet e krijuara nga janari i vitit 2023, duke na obliguar me vendosje të gurëve natyral si dhe shtrimin e rrugëve me zhavorr. Kontrata është 299.500 € dhe deri në fund të vitit 2023 kemi bërë shtrimin e rrugëve në fshatin Gjurgjevik i Vogël, Siqevë, Resnik, Dollovë, Zllakuqan, Budisalc, Rastokë, Dresnik, Ujmirë, Jashanicë dhe

rreth rrugëve të shtratit të lumit Klina dhe Drini i Bardhë ku kishin pësuar dëmtimet më të mëdha nga rritja e nivelit të ujit.

- **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit.**

Qyteti i Klinës ishte qyteti më i dekoruar në krahasim me qytetet tjera. Patëm numër të madh të qytetarëve që vinin edhe nga qytetet tjera, posaçërisht nga qytetet fqinje për t'u kënaqur me atmosferën e krijuar për më shumë se një muaj rresht. Ne kemi stolitur edhe këtë vit qytetin duke mundësuar edhe vendosje të kabinave, ku qytetarët kanë kaluar kohën e tyre me të dashurit e tyre, duke krijuar një mirëqenie edhe më të mirë për qytetarët.

- **Shërbime të veçanta për menaxhim, monitorim dhe funksionim të stacionit të autobusëve.**

Kemi angazhuar tre punëtorë për shërbime të veçanta në stacionin e autobusëve të Klinës ku ata kanë organizuar dhe monitoruar të gjitha obligimet sipas kontratës, kemi menaxhuar dhe përcjell ardhjen dhe daljen në punë të personelit, i cili orar organizohet sipas kontratës, kemi koordinuar punët organizative me drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente, dhe kemi raportuar në drejtorinë përkatëse.

- **Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në fshatin Rudicë.**

Komuna e Klinës ka investuar në fshatin Rudicë, duke zgjeruar rrjetin e ri të ndriçimit publik me 32 shtylla të betonit, 15 shtylla metalike dhe me 80 trupa ndriçues në fshatin Rudicë. Ky investim është pritur shumë mirë nga qytetarët e këtij fshati, ku ka ndihmuar shumë dhe ka rritur edhe sigurinë e ecjes gjatë mbrëmjes.

- **Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në qytetet dhe fshatrat e Klinës, Përçevë, Shtaricë dhe Shtupel me punë shtesë.**

Komuna ka investuar 95,885.00€ dhe 9,482.00€ punë shtesë në këto fshatra, duke krijuar linja të reja të ndriçimit publik, duke vendosur 30 shtylla të betonit, 270 trupa ndriçues 100Ë, 100 shtylla metalike në qytetin e Klinës. Kjo ka ndihmuar banorët e këtyre fshatrave dhe lagjeve, duke kuptuar se në Shtaricë dhe Përçevë nuk kishte ndriçim ekzistues.

- **Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Komunën e Klinës.**

Komuna ka investuar 97,980.00 € duke krijuar linja të reja në ndriçim publik në fshatrat Çabiq, Zabërgjë, lagjja "Mahalla" dhe një pjesë në fshatin Rudicë.

- **Mirëmbajtja e drunjve dekorativ.**

Në qytet kemi rreth 300 trupa të drunjve dekorativ, duke filluar nga sheshi “Ndue Përlleshi”, sheshi “ Mujë Krasniqi”, sheshi “ Nënë Tereza” e deri te sheshi “Faruk Elezaj”. Duke qenë se për tri vite rresht kjo pjesë e qytetit ishte në ndërtim për shkak të punimeve të tunelit dhe kalldrëmit, drunjte kishin pësuar dëmtime të mëdha, prandaj është dashur që në mënyrë profesionale të trajtohen të gjithë këta drunj , duke filluar nga krasitja, plehërimi, trajtimi me insekticide, instalimi i sistemit të ujitjes, punimit të tokës përreth etj. Tani pemët kanë marrë formë të mirë dhe të njëtrajtshme. Kanë rritje të mirë dhe janë të shëndetshme. Vlera e kontratës është 12,972.00 € dhe kontrata është tri vjeçare.

- **Furnizim me uniforma për zjarrfikës.**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka bërë edhe furnizimin e zjarrfikësve me uniforma. Duke kuptuar angazhimin dhe punën e rrezikshme të zjarrfikësve tanë, ne kemi bërë një furnizim me uniforma duke i ndërruar uniformat e vjetra të tyre të cilat në terren kanë pësuar dëmtime.

- **Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza Zllakuqan-Jashanicë-Gllarevë.**

Ka filluar edhe ndërtimi i impiantit në fshatin Gllarevë, ku kanë filluar punimet në gërmim dhe do të vazhdojë në muajt në vijim deri tek përfundimi i impiantit. Vlera e kontratës është 245,996.00 €.

- **Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe parqeve, trotuareve.**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka bërë mirëmbajtjen e hapësirave, parqeve dhe trotuareve, duke pastruar mbeturinat, largimin e tyre në depo dhe mirëmbajtjen e trotuareve, shesheve, rrugëve. Kontrata është gjashtëmujore.

- **Rregullimi i parqeve sipas paramanës në fshatin Ujmirë dhe Sferkë.**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, ka rregulluar parkun në fshatin Ujmirë dhe Sferkë, duke rregulluar hapësirën duke vendosur memorialin me mbishkrim për Dëshmorët e Martirët e Ujmirit, ndërsa edhe në Sferkë dhe Ujmirë ka rregulluar ndriçimin dhe këndin e lojërave për fëmijë së bashku me ulëse për qytetarë. Kontrata me vlerë 20,000 € për Ujmirë, dhe 14,659 € për Sferkë.

- **Njësia e Zjarrfikësve në Klinë**

NJPZSH në Klinë gjatë kësaj periudhe kohore aktivitetin e vetë e ka bazuar në planin e punës për vitin 2023 dhe si zakonisht ka arritur t'i përmbush me sukses objektivat e parapara me

plan.

NJPZSH ka vazhduar ta mbajë nivelin e gatishmërisë për reagime në rast nevojë edhe për raste emergjente për periudhën e lartcekur.

Ne jemi angazhuar që shërbimet tona të jenë në nivel të përgjegjësive dhe detyrës që na obligojnë ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës.

NJPZSH është përgjigjur në thirrjet për raste emergjente sipas obligimeve dhe me kapacitetet tona ekzistuese si dhe u jemi përgjigjur me kohë qytetarëve të dëmtuar dhe kemi lëshuar vërtetime për zjarret (dëmet) e ndodhura.

Nga NJPZSH në Klinikë gjatë kësaj periudhe ka pasur gjithsej 326 dalje, 255 raste zjarri dhe 71 in. teknike nga gjithsej 300 raste të planifikuara.

Në NJPZSH në Klinikë disiplina në punë dhe respektimi i orarit të punës është në nivel, ndërrimet janë kryer sipas orarit të paraparë dhe niveli i gatishmërisë si zakonisht ishte në nivel të lartë për t'ju përgjigjur kërkesave-nevojave të qytetarëve të komunës sonë dhe më gjerë, sipas nevojës dhe kapaciteteve tona ekzistuese.

Të dhënat e detajuara për intervenimet e NJPZSH gjatë periudhës janar-dhjetor janë paraqitur në tabeloren që pason:

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve dhe struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera për JANAR - DHJETOR 2023:

Viti: 2023 Komun a Klinikë	REALIZIMI I NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË DALJEVE DHE INTERVENIMEVE PËR MUAJIN JANAR –DHJETOR 2023							
	Nr.pë rgj. i dalje ve	Nr.i zjarreve	Shërbim e	Aksident e rrugore	Vërshime	Të rrejsh m e.	Të ndrysh me	Të lëndua r
	326	255	25	8	12	0	16	0

Viti - 2023	STRUKTURA E ZJARREVE				
	Objekte ndërtimore	Zjarre në sipërfaqe të hapura	Zjarre në automjete	Elektrika-pajisje elektrike	Të tjera
	12	222	11	10	71



**9.DREJTORIA E FINANCAVE,
EKONOMISË DHE
ZHVILLIMIT**

Drejtor: Enver A. Berisha

Gjatë vitit 2023 janë kryer punët në harmoni me Statutin Komunal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjin mbi Financat e Pushtetit Lokal, udhëzimeve administrative nga Qeveria Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi që dalin nga to dhe bazuar në Planin e punës së aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2023, siç vijon:

Janë përgatitur dhe lëshuar 1500 aktvendime të ngarkesave me taksë për licenca të subjekteve afariste që operojnë në komunën e Klinës në vitin 2023, të cilat aktvendime ju kanë dorëzuar të gjithë obliguesve të taksave në afatin e paraparë ligjor.

Janë lëshuar 575 aktvendime të Shfrytëzimit të pasurisë Komunale, akte të ndryshme administrative, të cilat aktvendime janë kompletuar me të gjitha aspektet administrative dhe financiare për realizimin e Planit të paraparë për vitin 2023.

Janë kryer 111 ankesa në terren të licencave dhe tatimit në pronë, 11 të bartura nga dhjetori i vitit 2022 dhe 100 periudha raportuese, duke lëshuar për çdo ushtrues të ankesës aktvendime mbi rezultatin e ankesës së ushtruar dhe dërguar deri te ushtruesi i ankesave.,

Janë lëshuar 2 kontrata të lokaleve komunale me qira komunale sipas urdhrit të eprorit kompetent.

Janë lëshuar 37 kontrata-marrëveshje dhe vendime të përgjithshme administrativo-juridike të Drejtorisë në sektorin e tatimit në pronë dhe për biznese.

Janë bërë më se 502 vlerësime të paluajtshmërive të ndryshme nga Komisioni për vlerësime të paluajtshmërive, e që janë pjesë e transfereve të arritura gjatë vitit 2023.

Janë lëshuar më se 305 vërejtje me shkrim për obliguesit e taksave që nuk i kanë kryer obligimet e taksave dhe të tatimit në pronë.

Janë lëshuar më se 41 akte administrativo-juridike, që ndërlidhen me Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Janë lëshuar mbi 500 njoftime për obliguesit tatimor dhe të taksave Komunale për obligimet e pa kryera gjatë vitit vijues.

Në këtë sektor, problem kyç është mosregjistrimi i disa subjekteve afariste që operojnë në komunën tonë ilegalisht dhe ato që i kanë mbyllur subjektet afariste, por nuk ju kanë nënshtruar procedurave ligjore të çregjistrimit, që paraqesin problem serioz gjatë ngarkesave vjetore të atyre subjekteve që nuk kanë sjell prova të dëshmuara për ndërprerje të veprimtarisë, respektivisht të mosaktivitetit afarist të tyre, por në koordinim me organet tjera relevante kompetente, si Inspektoratin Komunal etj. Në të ardhmen këtë problem kemi filluar ta evitojmë, por ende ka punë për t'u evituar tërësisht si pengesë të realizimit të ngarkesave vjetore sa më reale dhe të sakta, por për këtë pengesë është edhe vetiniciativa pasive e obliguesve tatimorë.

Gjatë vitit 2023 në zyrën e bizneseve janë regjistruar 152 biznese të reja, biznese individuale 55 biznese, shoqëri më përgjegjësi të kufizuara 97 biznese, biznese të shuara 27, kërkesa për shtim të aktivitetit 28 biznese, kërkesa për ndryshim të adresave 14 biznese, kërkesa për certifikata dublikatë 09 biznese, kërkesa për ndryshim të emrit 07 biznese, kërkesa për ndryshim të pronarëve 07 biznese, kërkesa për ndryshim apo shtim të aktivitetit të njësisve 07 biznese, kërkesa për ndryshim të drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar 03 biznese, kërkesa për ndryshim të emrit tregtar 03 biznese, kërkesa për shuarje të njësisë 02 biznese, kërkesë për ndryshim të numrit të punëtorëve 01 biznese dhe kërkesë për ndryshim të kapitalit 01 biznese. Gjithashtu, janë lëshuar edhe 62 licenca për taksi, 18 aktvendimeve të linjave për itinerar të autobusëve, dhe 06 aktvendime të zgjatjes së orarit për biznese.

Spektori për Buxhet dhe Financa

- Është bërë bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2022;
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për të gjitha programet;
- Janë përgatitur Pasqyrat financiare 2023;
- Janë bërë raporte financiare periodike gjatë vitit;
- Është bërë planifikimi i buxhetit për vitin 2023;
- Janë certifikuar të gjitha pagesat për mallra e shërbime dhe për punë;
- Shkresat për Ministrinë për EF në lidhje me transferet brenda programeve dhe kërkesat të ndryshme për realizim të projekteve;
- Janë bërë të gjitha zotimet për shpenzimet e bëra gjatë vitit;
- Është bërë evidencimi i tyre sipas programeve dhe kodeve ekonomike në Excel;
- Barazimi i rregullt i shpenzimeve me MF në baza tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore
- Janë realizuar pagesa për taksa komunale për vetura dhe për automjete të rënda;
- Është bërë regjistrimi i rregullt i të hyrave vetjake të paguara përmes arkës dhe bankës;
- Barazimi i rregullt i të hyrave me Departamentin e Thesarit në baza mujore;
- Regjistrimi i pasurisë komunale në Free balance,
- Regjistrimi taksës komunale në biznes;
- Kërkesa për alokim të të hyrave sipas realizimit dhe buxhetit të planifikuar;
- Janë lëshuar 145 certifikata të gjendjes ekonomike;
- Është bërë regjistrimi i mjeteve themelore në Free balance etj.

Spektori i tatimit në pronë

Spektori i tatimit në pronë gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer këto punë:

- Ka lëshuar 12992 fatura tatimore;

- Përmes bankës dhe arkës janë inkasuar **610.536.60** euro (duke tejkeluar inkasimin e vitit paraprak);

- Është punuar me komunitetin për rëndësinë e pagesës së tatimit në pronë, si dhe janë lëshuar mbi 6.572 vërtetime të kryerjes së obligimeve tatimore dhe shumë vërejtje për moskryerjen e obligimeve.

-Janë regjistruar **1045** objekte të reja që kanë hyrë në sistemin e ngarkesave sipas procedurave ligjore aplikative.

Janë dërguar 65 Propozime të Përmbartimit tek Përmbartuesi për realizimin e obligimeve të pakryera nga obliguesit e tatimit në Pronë, të cilat propozime e kanë dhënë efektin e mirë në realizim ku në këtë vit jemi një ndër komunat e para në Republikën e Kosovës që e kemi tejkeluar planifikimin e paraparë.

Si brengë që është paraqitur gjatë këtij viti vlen të përmendet te tatimi në pronë, sepse disa ndërmarrje që janë privatizuar dhe të tjerat që janë në proces të privatizimit, nuk kemi qasje të duhur së bashku me MEF-in për inkasimin e mjeteve financiare të tatimit në pronë të objekteve, qoftë të privatizuara, apo ato që janë në proces të privatizimit, e që organi kompetent i privatizimit nuk e detajon-precizon se nga cili obligues mbetet obligativ për kryerjen e këtyre obligimeve tatimore.

Risi tjetër te tatimi në pronë është edhe ngarkesa për shfrytëzuesit faktikë, që në fakt nuk janë pronarë juridikë të pronave që më së shumti kemi të bëjmë me pronarët e nacionalitetit joshqiptar, e që pronat e tyre i shfrytëzojnë shfrytëzuesit tjerë që dëshirojnë t'i ikin ngarkesave të tilla. Pastaj, rast tjetër që na pengon në këtë drejtim është se kamata e precizuar sipas ligjit nuk merret përsipër nga obliguesi faktik dhe juridik i pronarit legjitim, qoftë ai person fizik apo juridik.

RAPORT FINANCIAR PËR BUXHETIN, TË HYRAT DHE SHPENZIMET PËR PERIUdhËN JANAR – dhJETOR 2023

Për të analizuar realizimin e buxhetit për vitin fiskal 2023 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore, si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor të vitit paraprak si Shtojcë Raporti Financiar i vitit 2023 që i bashkëngjitet këtij raporti.

Në Zyrën e Thesarit është tejkaluar planifikimi i bërjes së pagesave të certifikuara gjatë vitit 2023 sipas Buxhetit të aprovuar në vlerë prej: **13.973.926.92€**. Në çështjen e pagesave të Zyrës së Thesarit, mendojmë se në këtë vit janë realizuar në përputhshmëri me Planin e punës së vitit 2023 dhe në afat të paraparë.

Gjatë vitit 2023 vlen të ceket se realizimi i të hyrave, shpenzimi i buxhetit si në projekte kapitale dhe kategoritë tjera buxhetore është realizuar në aspektin më pozitiv gjatë periudhës dhjetëvjeçare të raportimit. Ka dhe shumë çështje që duhet të cekem, por në tërësi mendojmë që ky vit kalendarik ka qenë një vit i realizimit të tërësishëm të objektivave tona të planifikuara dhe në disa raste edhe të tejkaluara. Më këtë raport jemi përpjekur që në pika më kryesore t'i përfshijmë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë që i kemi të përcaktuara sipas ligjeve aplikative në fuqi, me kusht që në të ardhmen këto obligime t'i rrisim, si në aspektin cilësor, ashtu edhe sasior.



10. DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtore: Qemajl Sejdiq

Drejtoria e Arsimit

Buxheti total për Drejtorinë e Arsimit 2023

Vlera totale e buxhetit: 5,324,906.67 €

Buxheti i shfrytëzuar %

Paga dhe medetje

100 %

Mallra dhe shërbime

92.53 %

Shpenzimet komunale

100 %


Subvencione dhe transfere

92.82 %

Shpenzimet kapitale

92.82 %

Buxheti 2023



RENOVIME DHE MIRËMBAJTJE TË OBJEKTEVE SHKOLLORE 2023

Vlera: 108,052.86 €





**Projektet nga kategoria
“Investime kapitale” 2023**

**Vlera totale e investimeve
140,956.34 €**



Renovimi i objektit të çerdhe "Xhevë Lladrovci"

Kemi investuar në inventarë të nevojshëm në shkollat e Komunës sonë për mirëmbajtjen e procesit mësimor dhe Drejtoria e Arsimit është e përkushtuar në rritjen e cilësisë në arsim edhe çdo investim që po bëhet, ka për qëllim që të krijohen kushte sa më të mira për mësimnxënie dhe mësimdhënie”.



Vlera: 12,966.48 €



Furnizim - montimi i pompës Tërmike

Kemi investuar në sistemin e ngrohjes qendrore në SHML “Fehmi Agani” prej 35,166.00 euro.



124,166.00 €

“

Renovimi i objektit dhe rregullimi i oborrit të shkollës

Renovimi i objektit dhe rregullimi i oborrit në SHFMU “Motrat Qiriazhi” në në vlerë prej 89,000.00 euro dhe në SHFMU “Ymer Berisha” Klinë.



29,550.00€



Furnizim - montimi i gjeneratorëve

Kemi investuar në sistemin e energjisë elektrike me furnizim dhe montim të gjeneratorëve në tri shkolla:

SHFMU “Ismet Rraci” Klinë në vlerë prej 8,550.00 €

SHFMU “Atë Shtjefen Gjeqovi” Zllakuqan në vlerë prej 8,550.00 €

SHFMU “Azem Bejta” Grabanicë në vlerë prej 8,550.00 €



25,650.00€




Transporti i nxënësve

Kemi siguruar transportin e nxënësve në relacionin shtëpi – shkollë dhe anasjelltas në mënyrë që nxënësve t'ua lehtësojmë rrugën e dijes dhe njëkohësisht evidentimin e rreziqeve.

Transporti u siguroa në këto relacione:

- Shtupel – Klinë
- Klinafc – Klinë
- Zajm – Klinë
- Gllarevë – Përçevë (Arsyeja: renovimi i shkollës së Gllarevës)
- Gjurgjevik i Vogël – Klinë
- Kosh – Zllakuqan
- Radulloç – Zllakuqan
- Krushevë e Madhe – Zllakuqan
- Lagjja Bakajes – Shtupel
- Qupevë e Ulët – Gremnik
- Qupevë e Lartë – Volljakë
- Dugajevë – Drenoc
- Pjetërq i Ulët – Drenoc
- Qeskovë – Këpuz
- Rastok – Këpuz
- Bokshiq – Grabanicë
- Dollovë – Grabanicë
- Shtaricë – Ujmirë
- Dobërdol – Ujmirë
- Resnik – Jashanicë
- Jelloc – Jashanicë



45,941.94

“

Shujtë ditore për fëmijë

Kemi siguruar furnizimin me shujtë ditore për fëmijë parafillorë dhe nxënës të klasave 1-5 në mënyrë që të sigurohet mirëqenia e fëmijëve.

Brenda këtyre shujtave ushqimore, përfshihen: Kifle të llojeve të ndryshme, me paketime higjienike për 5 ditë të javës.

Ky projekt është shumë i rëndësishëm dhe do të jetë një lehtësim ekonomik për prindërit si dhe barazi sociale për nxënës nga parashkollori deri në klasën e pestë, në secilën shkollë të komunës sonë!



76,141.00€



Furnizim me material për zyre dhe me material higjienik

Qëllimi i këtij projekti është që të krijojmë një ambient sa më të shëndoshë tek grupmoshat e reja sepse fëmijët janë pjesa më e ndjeshme e shoqërisë. Prandaj, fokusi i Drejtorisë së Arsimit është sigurimi i një ambienti të pastër dhe të përshtatshëm në mjediset shkollore.



19,887.05 €

“

Furnizim me inventarë

Kemi investuar në inventarë të nevojshëm në shkollat e Komunës sonë për mirëmbajtjen e procesit mësimor dhe Drejtoria e Arsimit është e përkushtuar në rritjen e cilësisë në arsim edhe çdo investim që po bëhet, ka për qëllim që të krijohen kushte sa më të mira për mësimnxënie dhe mësimdhënie”.



37,770.00 €

“

Këndi i lojrave

Drejtoria e Arsimit në Klinë ka investuar në këndin e lojrave në SHFMU “Ismet Rraci” dhe në çerdhen “Xhevë Lladrovci” në mënyrë që fëmijët të dëfrehen dhe të kenë një ambient atraktiv në shkollë.



5,999.00 €



Furnizimi me lëndë djegëse

Kemi furnizuar shkollat e nevojshme me lëndë djegëse sipas kërkesave të tyre.

Furnizim me naftë për ngrohje për vitin 2023 kemi pasur dy shkolla:

Qabiq me 3000 litra vlera $3000 \times 1.25 = 3750$ euro

Gremnik me 3000 litra vlera $3000 \times 1.25 = 3750$ euro

Furnizimi me dru në shkolla është bërë në të gjitha shkollat sipas kërkesave të shkollave.

Kontrata e shpenzuar deri me 28.12.2023 është 982 metra dru ku çmimi për metër dru është 53 euro sipas kontratës $982 \times 53 = 52046$ euro për Drejtorinë e Arsimit.

Furnizimi me pelet në shkolla është bërë në të gjitha shkollat sipas kërkesave të shkollave.

Kontrata e shpenzuar është gjithësejt 121 tonë pelet $121 \times 319 = 38599$ euro.



98,145.00 €



Trajnime të organizuara për zhvillimin profesional të mësimeve

Trajnimet konsiderohen si pika të veçanta prej së cilave mësimeve do të aftësoheshin në përdorimin e drejtë të reformave në praktikën mësimore.

Prandaj, Drejtoria e Arsimit në Klinë organizoi trajnime të ndryshme për mësimeve/et me qëllim që t'u përshtaten reformave në arsim.



“

Bursa për studentët

Në këtë vit komuna e Klinës ka ndarë 60 bursa për 60 studentë të komunës tonë të nivelit bachelor, të cilët do të përfitojnë bursë në vlerë prej 600 euro. Përzgjedhja e studentëve përfitues është bërë nga komisioni komunal. Mbështetja e të rinjve dhe studentëve ka qenë dhe mbetet një nga synimet dhe prioritetet e Komunës së Klinës. Duke i ditur nevojat dhe sfidat e studentëve e për t'ju krijuar atyre mundësi më të mira financiare për mbulimin e shpenzimeve të studimit, me një planifikim të duhur buxhetor kemi arritur ta rrisim numrin e përfituesve të bursave nga 30 sa ka qenë më herët në 60 përfitues.



36,000.00 €



Shpërblime për nxënësit me rastin e Ditës së Çlirimit

Investimi në arsim, në edukimin e arsimimin e të rinjve, në krijimin e mundësive të reja e të duhura për nxënësit është investimi më i rëndësishëm dhe i duhur për ne. Përveç krijimit të kushteve infrastrukturore në objekte shkollore, për të rritur nivelin e mësimnxënies duhet edhe të stimulojmë nxënësit në forma të ndryshme.

Në vigjilje të 18 qershorit, Ditës së Çlirimit të Klinës, kemi ndarë shpërblimet në vlera monetare për nxënësit fitues në garat komunale për ese dhe matematikë. Po ashtu, kemi ndarë edhe mirënjohje për nxënësit fitues në garat shtetërore dhe ndërkombëtare, ku nxënësit nga Klina kanë treguar rezultate të shkëlqyeshme dhe kanë përfaqësuar Republikën e Kosovës në mënyrë të dinjitetshme, duke na bërë krenar të gjithë ne.






Organizimi dhe monitorimi i garave

Organizimi dhe monitorimi i garave dhe olimpiadave të niveleve të ndryshme në bashkëpunim me MASHTI-n dhe organizata që kanë lejen e MASHTI-t për zhvillim të këtyre aktiviteteve.

Koordinimi i aktiviteteve me MASHTI-n për organizimin dhe administrimin e vlerësimit të jashtëm (testit nacional të klasës IX dhe provimit të maturës shtetërore), por edhe për vlerësimin ndërkombëtar PISA 2022 dhe testimin provues TIMSS 2023.





Bashkëpunim i vazhdueshem me Policinë dhe KFOR-in

Si në vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2023 kemi pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in për sigurinë e fëmijëve dhe vetëdijesimin e tyre për fenomenet e këqija më të cilat po rrezikohen fëmijët tanë ku në secilën prej shkollave të Komunës e Klinës u organizuan ligjërata vetëdijësuese në të mirën e fëmijëve dhe sigurinë e komunitetit.

Poashtu KFOR-i ofroj mbështetje me donacione për disa shkolla të Komunës tonë me materiale të nevojshme.



KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-3468 /2024

Klinë, me 01, 02 /2024



KRYESUES

Fadil Gashi

I,